REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02-180/01/25**
**Datë: 24.01.2025**

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

# FTESË

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Nga:** **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Lënda:** Mbledhja e parë (01) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;**
**Data: 31.01.2025**, ora 10 00.

## Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhen, janar-dhjetor 2024;
4. Përmirësimi i Vendimit Nr. 02/24/2024 i datës 26.11.2024 mbi Normat Tatimore për vitin 2025;
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2024;
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024;
7. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2024;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSB-së përt vitin 2025;
9. Përmirësimi i Vendimit Nr. 02/23/24 i datës 30.12.2024 Rregullorja për Transparencë 2024-2028 dhe Plani i Veprimit sipas rekomandimit të ministrisë së linjës;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për të drejtat e fëmijëve;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Komitetit për Komunitete;
12. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
13. Të ndryshme.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK**

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02-180/01/25**
**Datë: 24.01.2025**

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

# FTESË

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Nga:** **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Lënda:** Mbledhja e parë (01) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Vendi:** **Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut**;
**Data:** **31.01.2025**, ora **10 $^{00}$**.

## Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhen, janar-dhjetor 2024;
4. Përmirësimi i Vendimit Nr. 02/24/2024 i datës 26.11.2024 mbi Normat Tatimore për vitin 2025;
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2024;
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024;
7. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2024;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSB-së përt vitin 2025;
9. Përmirësimi i Vendimit Nr. 02/23/24 i datës 30.12.2024 Rregullorja për Transparencë 2024-2028 dhe Plani i Veprimit sipas rekomandimit të ministrisë së linjës;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për të drejtat e fëmijëve;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Komitetit për Komunitete;
12. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
13. Të ndryshme.

Adresa:
Tel.: +386 (0) 44 270 947
**http://kk.rks-gov.net/junik**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/429
Nji. Org. 2
Nr. i fleta. 1
Data 13/01/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 13.01.2025 |
| PËR/ZA/TO: | z. Shpejtim Gacaferi– Kryesues i Kuvendit Komunal |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe në Kuvend përmirësimin e vendimit mbi Normat Tatimore për vitin 2025 |

I nderuar,

Duke u bazuar në rekomandimin e dhënë nga Ministria e Financave- Departramenti ligjor për riformulimin e perambulës së vendimit numër 2-180/10693 i nxjerrë nga Kuvendi Komunal me datë 02.12.2024, mbi Normat Tatimore për vitin 2025, kërkojmë që të shtohet në rendin e ditës në mbledhjen e radhës në KPF dhe në Kuvendin Komunal pika:

1. Përmirësimi i vendimit nr: 2/180/10693 mbi Normat Tatimore për vitin 2025.

Ndryshimet:

Riformulimi i perambulës nga **"neni 9 i Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme"** zëvendësohet me **"neni 35 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025"**.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/676
Nje. Org. 1
Nr. i faq. 23
Data 24/01/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| Referencë/Reference: | Nr. 8-1/25 |
| PËR/ZA/TO: | z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues në Kuvendin Komunal - Junik |
| CC. | Anëtarët e Kuvendit Komunal në Junik |
| PËRMES | z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës - Junik |
| NGA/OD/FROM: | z. Fatos Shala Drejtor për SHMS-së - Komuna Junik |
| DATË/A: | 24.01.2025 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për miratim te Planit të punës për të drejtat e fëmijëve |

Te nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që kemi dhe duke qenë të vendosur që të kemi bashkëpunim edhe më tutje, kërkojme nga ju që të futet si pikë në rendë të ditë Kërkesë për miratim e Planit të punës për të drejtat e fëmijëve .

Kjo kërkësë bëhet duke u bazu në rekomandimet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) e cila mbart përgjegjësinë për monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ (QKR) Nr. 06/2022, të miratuar më 15 gusht 2022. ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat për funksionimin e Ekipeve për të Drejtat e Fëmijës (EDF), duke zbatuar Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës

Shpresojmë që kërkesa jone do të gjejë mirëkuptim nga ana juaj!

Ju falënderojmë për bashkëpunim!

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT-OPSTINA JUNIK-MUNICIPALITY JUNIK

# PLANI I PUNËS
# PËR
# EKIPIN KOMUNAL PËR TË DREJTAT E FËMIJËS - JUNIK
# (2025 – 2027)

Junik, Janar 2025

Përmbajtja


PARATHËNIE ..... 3
HYRJE ..... 4
KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL ..... 5
PARIMET DHE VLERAT ..... 5
QËLLIMI JONË ..... 6
FUSHAT E VEPRIMIT ..... 7
OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMET ..... 7
OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë ..... 7
OBJEKTIVI 2: Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve ..... 10
OBJEKTIVI 3: Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët ..... 11
OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit ..... 12
OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre ..... 13
OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë ..... 14
PLANI I VEPRIMIT ..... 15

# PARATHËNIE

## FJALA E KRYETARIT

Plani i Punës për të Drejtat e Fëmijëve është një nismë e cila çon në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të drejtave të fëmijëve në qytetin tonë në Junik.

Në Komunën e Junikut jemi të vendosur të sigurojmë një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për fëmijët tanë. Nëpërmjet Planit të Punës për të Drejtat e Fëmijëve, synojmë të rrisim ndërgjegjësimin rreth të drejtave të fëmijëve dhe të adresojmë sfidat që ata përballen në jetën e tyre të përditshme.

Padyshim, ndër qëllimet dhe prioritetet kyçe të planit tonë janë përmirësimi në arsim, duke ndërmarrë masa për të siguruar qasje të barabartë dhe cilësore në arsim për të gjithë fëmijët e komunës tonë. Kështu, do të zhvillojmë programe të cilat do të krijojnë ambiente të sigurta dhe të përshtatshme mësimore, duke mos harruar asnjëherë t'i përkrahim fëmijët me nevoja të veçanta.

Do të kujdesemi t'i mbrojmë fëmijët nga dhuna dhe abuzimi, duke mos toleruar ansjë formë të dhunës apo abuzimit ndaj fëmijëve, dhe do të ndërmarrim masa për të ndërgjegjësuar komunitetin për të siguruar ndihmë dhe mbrojtje të menjëhershme për fëmijët që janë viktima të dhunës.

Nuk do e lëjmë pas promovimin e shëndetit dhe mirëqenies, duke pas për qëllim ta përmirësojmë shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve në komunën tonë. Do të organizojmë programe shëndetësore parandaluese, duke frymëzuar ushqyerjen e shëndetshme dhe aktivitete fizike, si dhe do të ofrojmë mbështetje psikologjike për fëmijët dhe familjet e tyre.

Gjithsesi, do të bëhen investime edhe në infrastrukturën sportive e cila do të frymëzoj më shumë aktivitete sportive në të gjitha moshat, duke ndërtuar fusha të futbollit, dhe duke ofruar hapësira të reja për talentet e ri të sportit. Do të organizohen vazhdimisht aktivitete sportive, kulturore dhe rinore për fëmijët, duke i frymëzuar ata të zhvillojnë pasionet e tyre.

Nuk do të ndalemi asnjëherë së investuari në infrastrukturën e shkollave dhe mjeteve të duhura për të përmbushur nevojat e fëmijëve, si dhe të ndërtojmë mekanizma mbrojtëse për t'i shpëtuar ata nga dhuna dhe rreziku i mundshëm.

Ne duhet të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për të siguruar përparim të qëndrueshëm për të drejtat e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.

Për fund, mirënjohje dhe falenderim i veçantë për përkushtimin dhe angazhimin e hartuesve të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës në Junik (2025-2027).

Singerisht,
Ruzhdi Shehu
Kryetari i Komunës së Junikut

# HYRJE

Komuna e Junik i kushton rëndësi mirëqenies së të gjithë qytatarëve të saj. Me politikat dhe praktikat e saja, qeverisja komunale siguron shërbime cilësore për qytetarët, pavarësisht përkatësisë së tyre mbi çfarëdo baze. Sidoqoftë, fëmijët janë një grup i qytetarëve tanë që konsiderohen si kategori e veçantë dhe në nevojë në vështrim të gëzimit të të drejtave të tyre të njeriut. Për shkak të moshës së tyre, ata ende nuk e kanë zhvillimin e plotë fizik, kognitiv e emocional. Prandaj varen nga të rriturit në gëzimin e të drejtave të tyre. Si Komunë ne jemi të përcaktuar të vihemi në brojtje të të drejtave të tyre dhe në ofrimin e kushteve për zhvillim të plotë të tyre. Ky përcaktim, reflektohet në politikën tonë qeverisëse e cila është miqësore për fëmijët.

Ky dokument i hartuar do të shërbejë si dokument pune për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës, si organ i themeluar së voni nga komuna për të mbarështuar politikat dhe praktikat në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Plani i punës është hartuar në përputhje me praktikat e promovuara të qyteteve mike për fëmijë dhe përmban fusha të ndryshme të veprimit, të nevojshme për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

Procesi i hartimit të planit të punës ka qenë proces dinamik dhe me pjesëmarrje të gjerë, përfshirë sektorët komunalë, institucionet qendrore, organizatat e specializuara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe vetë fëmijët .

Disa nga veprimet që i kanë paraprirë hartimit të kësaj strategjie janë:

- Janë organizuar konsultime paraprake me palë të ndryshme që kanë ndihmuar në mbledhjen e informatave themelore dhe përgatitjen e procesit të planifikimit;
- Është organizuar një punëtori me 24.11.2023 me qëllim të hartimit të planit të punës për të drejtat e fëmijëve me pjesëmarrje të Ekipit për të drejtat e fëmijëve, ku janë identifikuar fushat e veprimit, si dhe është përcaktuar logjika e intervenimit;
- Është organizuar konsultimi me përfaqësuesit e fëmijëve në Shkollat e Komunës së Junikut për të marrë mendimin e tyre për perspektivën e fëmijëve dhe sugjerimet e tyre lidhur me planin e punës;
- Është mbajtur një takim përcjellës me një grup të ngushtë punues në nivel komunal për të validuar përmbajtjen e planit të punës.

I gjithë procesi është udhëhequr nga Kryesuesi i Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, njëherit kryetari i komunës së Junik, z. Ruzhdi Shehu dhe Zv/kryesuesi e Ekipit z. Fatos Shala Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Behar Fetaj Zyrtar i QPS-s së Junikut.

## KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL

Pa dyshim se Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës[1] është bazamenti i secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijëve. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale. Detyrimisht, edhe ky plan i punës është ndërtuar mbi parimet udhëheqëse të Konventës.

Në nivel vendi veprimi për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës është planifikuar përmes strategjive. Kështu, sikurse strategjitë pararendëse, edhe Strategjia për të Drejtat e Fëmijës 2019 – 2023[2] përcakton obligimin e autoriteteve në nivelin vendor dhe lokal për qeverisje që mundëson realizimin e të drejtave të fëmijëve. Objektivi i dytë strategjik në këtë strategji kërkon që qeverisja lokale t'i prioritizojë të drejtat e fëmijëve, duke synuar përmirësimin e jetës së fëmijëve brenda juridiksionit të tyre në përputhje me obligimet që rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe korniza ligjore vendore.

Në Kosovë, për një kohë të gjatë ka munguar ligji për mbrojtjen e fëmijës. Në vitin 2019 ky ligj është miratuar dhe i ka hapur rrugën operacionalizimit të tij përmes akteve nënligjore dhe krijimit e funksionimit të mekanizmave mbrojtës për fëmijët. Kështu Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës[3] ndër të tjera përcakton që Ekipi për të Drejtat e Fëmijës krijohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës në nivel të vendimmarrjes politike. Në nenin 20 jepen edhe konturat e fushëveprimit të këtij ekipi. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë udhëzimin administrativ 06/2022[4] për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës, që përcakton mënyrën e themelimit dhe aspektet e funksionimit të këtij ekipi.

Kryetari i Komunës, në përputhje me UA 06/2022, më 13 Prill 2023 ka nxjerrë vendim për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës. Mbledhja konstitutive për themelimin e Ekipit është mbajtur në Mars 2023.

Ky plan trevjeçar i punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është hartuar në përputhje me parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, me politikat e nivelit qëndror e lokal, si dhe me konceptin e komunave mike për fëmijë.

## PARIMET DHE VLERAT

Në Komunën e Junik promovohet modeli i qeverisjes lokale që u shërben njësoj të gjithë qytetarëve të vet, duke u ofruar në të njëjtën kohë mundësi të gjithëve të shprehin potencialin e tyre dhe të kontribuojnë aktivisht në mirëqenien e përgjithshme shoqërore. Një model i këtillë promovohet edhe në raport me fëmijët. Ata nuk janë marrës pasivë të shërbimeve të të rriturve por anëtarë aktivë të komunitetit. Si të tillë edhe trajtohen, duke i përfshirë në proceset komunale që lidhen me jetën e tyre dhe duke krijuar kushtet që të

[1] https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf
[2] https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Alb-Track-Changes-Strategjia-per-te-drejtat-e-femijeve-FINAL-12032019.pdf
[3] https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844
[4] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596

zhvillojnë gjithë potencialin e tyre. Si ekip e si komunë, jemi të përcaktuar që proceset në komunë të jenë jo vetëm "për fëmijët" por edhe "me fëmijët".

Në punën tonë si ekip, udhëhiqemi nga parimet themelore të të drejtave të fëmijëve të cilat janë të gdhendura në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës:

- **Mosdiskriminimi** - të gjithë fëmijët duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Asnjë fëmijë nuk duhet ta vuaj diskriminimin mbi çfarëdo baze.
- **Interesat më të mira të fëmijës** - kur merren vendime që ndikojnë në fëmijët, interesave më të mira të fëmijës duhet t'u jepet vëmendje parësore.
- **Jeta, mbijetesa dhe zhvillimi** – të gjithë fëmijëve duhet t'u sigurohet mbijetesa dhe zhvillimi deri në masën më të madhe të mundshme. Zhvillimi përfshin edhe dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik, por edhe zhvillimi mental, emocional, social dhe kulturor.
- **Pikëpamjet e fëmijës** - fëmijët duhet të jenë të lirë të shfaqin pikëpamjet lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre pikëpamjeve duhet t'u jepet peshë e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijëve.

Ndërtimin e komunës mike për fëmijë e ushqejmë përmes **vlerave të përbashkëta**. Këto vlera lidhen me komunën ku fëmijët:

- Dëgjohen dhe kanë ndikim;
- Janë të mbrojtur nga dhuna e keqtrajtimi;
- Ndihen të sigurt;
- Luajnë e argëtohen;
- Përfshihen lirisht;
- Krijojnë miqësi dhe ndihen të lidhur me komunitetin;
- Kanë mundësi për të mësuar dhe për të zhvilluar shkathtësitë;
- Ndihen të respektuar;
- Krijojnë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe të tjerëve.

## QËLLIMI JONË

**Krijimi i një sistemi qeverisës komunal që siguron mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve të komunës, përmes bashkërendimit të të gjithë sektorëve komunalë dhe bashkëpunimit me të gjitha palët.**

Ne do të ofrojmë një model të qeverisjes lokale që si konsideratë mbizotëruese do t'i ketë interesat më të mira të fëmijëve të komunës. Përmes bashkërendimit të punëve të të gjithë sektorëve komunalë, do të ofrojmë shërbime shumëdimensionale për fëmijët. Në të gjitha fushat e veprimit do të krijojmë lidhje bashkëpunimi me partnerët dhe komunitetin, që

fëmijëve t'u krijojmë një mjedis jetësor të këndshëm dhe mundësues. Vëmendje të vazhdueshme do t'i kushtojmë përfshirjes aktive të vetë fëmijëve në të gjitha proceset vendimmarrëse në komunë që lidhen me jetën e tyre. Jemi të bindur se vetëm kështu fëmijët tanë do të bëhen qytetarë të ndërgjegjshëm.

## FUSHAT E VEPRIMIT

Janë identifikuar gjashtë fusha të veprimit në kuadër të planit të punës. Këto fusha, ndonëse janë të veçanta, në asnjë mënyrë nuk mund të adresohen si të vetme. Përkundrazi ato janë të lidhura ngusht në mes veti dhe e plotësojnë njëra-tjerën, duke e bërë planin e punës koherent e gjithëpërfshirës.

1. Sherbimet cilësore për fëmijë
2. Vetëdijesimi dhe avokimi për fëmijë
3. Hapësirat e sigurta e miqësore për fëmijë
4. Sporti, loja dhe rekreacioni për fëmijë
5. Pjesëmarrja e fëmijëve
6. Koordinimi, vlerësimi e raportimi

## OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMET

Këto fusha prioritare, janë përkthyer në objektiva strategjike dhe më tutje përmbajnë masa që përmbushin këto objektiva. Secila masë brenda objektivit përkatës është zbërthyer më tutje në veprime konkrete, që shërbejnë si udhërrëfim në fazën e zbatimit të planit të punës.

### OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë

Ne duam t'i përmirësojmë shërbimet e sektorëve si mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike, duke u ofruar fëmijëve të komunës kushtet më të mira të mundshme dhe duke e mbështetur zhvillimin e plotë të fëmijëve. Në këta sektorë respektivë do të identifikohen nevojat specifike dhe llojet e shërbimeve bazë të cilat duhet të përmirësohen apo edhe shërbimet shtesë. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet kategorive të fëmijëve që kanë më së shumti nevojë siç janë fëmijët nga familjet që janë

përfitues të skemës së ndihmës sociale, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme, etj.

Krahas ofrimit të shërbimeve për fëmijët, do të ofrohet mbështetje për familjet dhe komunitetin përmes edukimit, sikurse edhe do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve të fushave të ndryshme që ta përmirësojnë cilësisë e shërbimeve që ofrojnë.

### 1.1 Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë

Do të krijohet një sistem për të mbajtur publikun të informuar për të gjitha shërbimet që ofrohen në komunë. Fillimisht do të bëhet evidentimi i të gjitha shërbimeve ndaj fëmijëve. Më tutje do të zhvillohet një katalog i llojeve të shërbimeve sociale që ofrohen dhe i ofruesve të shërbimeve. Do të organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, medias , ueb faqes së komunës dhe kanaleve tjera të komunikimit.

### 1.2 Ndarja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme

Fëmijët që gjenden në rrethana të jashtëzakonshme kërkojnë përkrahje institucionale në kuptim të ofrimit të shërbimeve profesionale, por edhe ofrimit të shërbimeve logjistike, siç janë ushqimi, transporti, akomodimi, etj. Për këtë arsye do të ofrohet një financim emergjent për këta fëmijë dhe do të krijohet një sistem për menaxhimin e këtij financimi dhe këtyre shërbimeve emergjente. Do të evidentohen nevojat për shërbime emergjente dhe do të kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

### 1.3 Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore

Koncepti i familjeve strehuese dhe farefisnore është provuar si i suksesshëm, prandaj edhe është i paraparë me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës. Ne do ta promovojmë si shërbim dhe do të ndërmarrim një fushatë për të krijuar dhe rritur numrin e këtyre familjeve. Do të bëjmë identifikimin dhe vlerësimin e familjeve strehuese dhe farefisnore dhe do të trajnojmë këto familje. Trajtimi i fëmijëve brenda këtyre familjeve do të monitorohet.

### 1.4 Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv

Modulet ekzistuese të prindërimit të mirë do të përshtaten për nevoja të komunitetit. Po ashtu, do të krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit dhe do të shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve e sesioneve të informimit.

### 1.5 Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për ta regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën

Arsimi i obligueshëm nënkupton që çdo fëmijë i moshës shkollore ta vijojë shkollimin. Megjithatë, edhe në komunën tonë ballafaqohemi me raste të mosregjistrimit, mosvijimit të rregullt dhe braktisjes së shkollimit. Ne do të marrim masa për gjithëpërfshirje në shkollim. Do të krijohet një sistem i komunikimit mes shkollave dhe zyrave të regjistrimit civil për t'i marrë të dhënat e fëmijëve të moshës shkollore nga zona që gravitojnë shkollat, në mënyrë që të lehtësohet procesi i

regjistrimit në shkollë. Shkollat do të mirëmbajnë bazën e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Më tutje, do të funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM), si dhe do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim.

### 1.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla

Do të trajnohen mësimdhënësit për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike dhe psikosociale dhe krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale. Po ashtu do të identifikohen nevojat për mësimdhënës mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do të angazhohen këta mësimdhënës në shkollat e komunës.

### 1.7 Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore

Gjendja e objekteve shkollore ndikon shumë në cilësinë e arsimit. Prandaj, ekipet profesionale do ta inspektojnë gjendjen e shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj). Këto ekipe do të inspektojnë objektet shkollore në baza vjetore dhe do të dalin me raporte vlerësuese. Mbi bazën e raporteve do të ndërmerren masa përmirësuese me qëllim të krijimit të objekteve dhe mjediseve shkollore miqësore për fëmijë. Standardet e shkollave mike për fëmijë do të promovohen vazhdimisht.

### 1.8 Krijimi i makanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore

Kultura shkollore duhet ta ketë pjesë të saj të vazhdueshme mirëmbajtjen e objekteve shkollore. Prandaj për të siguruar angazhimin e të gjitha palëve në shkollë në këtë drejtim, do të vetëdijesohen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes dhe kujdesin ndaj mjedisit shkollor. Do të hartohet një udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore. Çdo vit do të ndahen shpërblime për komunitetet më të vyeshme shkollore.

### 1.9 Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit

Do të promovohet shëndeti përmes fushatës vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe përmes edukimit shëndetësor të qytetarëve e ligjëratave për edukimin shëndetësor dhe reproduktiv për nxënësit e shkollave. Po ashtu, do të organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca.

### 1.10 Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike

Do t'i kushtohet kujdes ofrimit të shërbimeve të individualizuara shëndetësore për secilin fëmijë. Prandaj do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe përkrahje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Do të organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, të cilat do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ. Do të zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal dhe vizitave për nënat dhe fëmijët. Kontrollet sistematike shëndetësore do të realizohen edhe nëpër shkolla.

### 1.11 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me nevoja të veçanta

Do të përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta. Do të promovohen shërbimet institucionale dhe ato të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijë me nevoja të veçanta, me fokus në përfitimet e FNV dhe familjeve të tyre.

Do të hartohet dhe përdoret një formular për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë. Për ata fëmijë që kanë parametra që identifikojnë nevojën për kontroll më të hollësishëm, do të ndërmerren vlerësime dhe do të rekomandohen masa që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit)

### 1.12 Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë

Do të ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi për FNV, përmes subvencionimit të organizatave të licencuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Do t'i kushtohet kujdes sigurimit të qasjes fizike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësirat publike duke i paraprirë me identifikimin e nevojave për sigurimin e qasjes fizike. Më tutje do të ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cenueshme: fëmijët që punojnë, fëmijët viktima të trafikimit, etj.). Programe të tilla do të jenë mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.

## OBJEKTIVI 2: Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve

Ne duam që në bashkëpunim me partnerët tanë, të krijojmë një sistem efektiv për të vetëdijesuar të rriturit, por edhe vet fëmijët për të drejtat e fëmijëve, mirëqenien e tyre dhe për komunën mike për ta. Programet për informim dhe zhvillim profesional për të gjitha palët duke përfshirë edhe politikëbërësit e zyrtarët më të lartë komunalë, janë të një rëndësie të veçantë. Në të njëjtën kohë, ne do t'i inkurajojmë organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e pavarura që të avokojnë për fëmijët. Ndërkaq, do të shfrytëzohet edhe media për promovimin e të drejtave të fëmijës.

### Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve.

Me rëndësi konsiderohet që politikëbërësit dhe zyrtarët komunalë si bartës të funksioneve, të jenë mirë të informuar dhe të kenë aftësi vlerësimi e gjykimi për aspekte të të drejtave të fëmijëve. Prandaj, do të organizohen trajnime për ta në temat e njohjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, instrumenteve ndërkombëtare, legjislacionit dhe rregullativës që lidhet me të drejtat e fëmijëve, vlerësimit dhe raportimit të gjendjes së fëmijëve, standardeve të operimit, investimit publik në fëmijë, etj.

### 2.1 Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët

Qytetarët duhet të vetëdijesohen për atributet e komunës mike për fëmijë dhe të aktivizohen si qytetarë të përgjegjshëm. Prandaj, do të organizohen fushata

vetëdijesuese për të rritur dhe fëmijë. Fushatat do të përfshijnë ligjëratat publike, shpërndarjen e materialit promovues, ofrimin e trajnimeve me profesionistë të fushave të ndryshme si dhe me prindër, etj. Ndërsa fëmijëve do t'u ofrohen programe për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë demokratike brenda kurrikulit shkollor dhe përmes edukimit joformal.

**2.2 Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës**

Ne do të jemi transparentë dhe të gatshëm për të shqyrtuar e për adresuar opinionet e të gjitha palëve, lidhur me qeverisjen komunale. Në vështrim të veprimit të përgjegjshëm karshi fëmijëve, do t'i mbajmë dyert e hapura për organizatat joqeveritare, koalicionet e rrjetet që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Për më shumë, do të përkrahet puna e tyre. Po ashtu do të mundësohet dhe përkrahet puna e vetë organizatave të fëmijëve dhe të rinjve në avokimin për të drejtat e tyre.

**2.3 Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias**

Shfrytëzimi i mediumeve të ndryshme për të gjeneruar lajme të përgjegjshme për fëmijët dhe në interesin më të mirë të tyre është shumë i rëndësishëm. Për të siguruar këtë, do të ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyren komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatin e ekipit si dhe për mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike. Do të përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale. Po ashtu, do të organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit të fëmijëve

## OBJEKTIVI 3: Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët

Ne duam që hapësirat në të cilat frekuentojnë fëmijët të jenë plotësisht të parrezikshme për ta dhe t'u krijojnë atyre ndjenjën e sigurisë në çdo kohë, edhe atëherë kur janë vetëm. Komuna do të përfshijë aktivisht fëmijët dhe prindërit në konsultime gjatë rregullimeve urbanistike, do të përmirësojë higjienën kolektive, do të krijojë kushte për qarkullim të lirë e trafik të sigurt, do të shmang rreziqet në hapësira publike dhe do të krijojë mjedis ekologjik.

**3.1 Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët**

Në komunë, trafiku është i ngarkuar me numër të madh të automjeteve dhe vuan nga problemet me parkingje, shtigje për këmbësorë e biçiklista. Kjo situatë më së shumti i

kërcënon fëmijët. Për të përmirësuar këtë situatë, do të hartohen dhe zbatohen projekte për lirimin e trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, shtigjeve të biçiklistëve, etj. Ndërkaq, me të gjithë pjesëmarrësit në trafik do të ndërmerret një fushatë informimi për sigurinë në trafik.

### 3.2 Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik

Hapësirat publike shpesh përbëjnë rrezik për fëmijët, për shkak të dëmtimeve të këtyre hapësirave. Prandaj, do të monitorohen në mënyrë sistematike hapësirat publike për të identifikuar rreziqet eventuale për fëmijët (shtretërit e lumenjve, deponitë, rrënojat, gropat e pusetat e pambuluara, trotuarët e vendkalimet e pashenjuara, lodrat për fëmijë, etj.) dhe do të merren masa për eliminimin e tyre. Komuna do të mbështetet edhe në ndihmën e publikut në raportimin e rreziqeve të tilla. Kështu, do të promovohet një linjë telefonike për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe do të merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër. Kjo linjë telefonike mund të jetë 112 apo një linjë e ngjashme.

Për shkak të koncentrimit të madh të fëmijëve rreth shkollave, do të merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës, që mund të vijnë nga prania e personave të dyshimtë, shitja e artikujve të dëmshëm, etj. Po ashtu në nivel komune dhe në bashkëpunim edhe me nivelin qendror do të bëhet sistemimi i qenve endacakë.

Më tutje do të ndërmarren veprime të rritjes së hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.

## OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit

Loja, rekreacioni dhe sporti janë elemente të rëndësishme të zhvillimit të fëmijëve dhe segmente ku ata shfaqin talentet e tyre. Prandaj, do të promovohet pjesëmarrja e fëmijëve nëpër klube sportive e institucione kulturore. Shkollat do të jenë institucionet që përtej kurrikulit formal do të krijojnë hapësirën dhe mundësitë për aktivitete të kohës së lirë, rekreacion e sport për nxënësit. Po ashtu, shkollat do të krijojnë lidhjet me klubet sportive, klubet artistike e kulturore, në mënyrë që fëmijët të mund t'i zhvillojnë më tutje talentet e tyre në fushat në të cilat kanë interesim. Hapësirat publike do të adaptohen që të sigurojnë argëtim e kohë të lirë për fëmijët nëpër lagje.

### 4.1 Promovimi i sportit nëpër shkolla

Në nivel të shkollave do të zhvillohen kapacitetet njerëzore që do të marrin përgjegjësinë e promovimit të sportit shkollor. Do të krijohen klubet sportive në nivel të shkollave dhe do të organizohen gara shkollore në sporte të ndryshme. Rëndësi do t'i kushtohet përfshirjes gjinore dhe thyerjes së stereotipeve gjinore.

### 4.2 Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja

Do të punohet me klubet sportive ekzistuese në aktivizimin e klubeve për kategoritë e reja për vajza dhe djem. Për të rekrutuar fëmijë dhe të rinj në klube, do të bashkëpunohet me shkollat dhe do të mbahen kampe për identifikimin e talenteve.

### 4.3 Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë

Do të ofrohen programe artistike e kulturore nëpër shkolla, ku fëmijët do të demonstrojnë shkathtësitë e tyre. Klubet artistike e kulturore të shkollave do të lidhen me organizata të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, etj., për të ofruar mundësi shtesë për fëmijët që kanë afinitet në këto fusha. Po ashtu, do të përkrahen shkollat dhe institucionet në promovimin e hapësirave për programim, kodim, ueb dizajn, etj. Praktika të tilla tashmë janë instaluar në nivel të shkollave, dhe do të zhvillohen më tutje.

### 4.4 Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

Lagjet tona duhet të ofrojnë hapësira të rekreacionit ku fëmijët mund të çlodhen e shoqërohen. Për këtë arsye, do të inspektohet situata me parqet ekzistuese dhe do të identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë. Më tutje, do të intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja. E gjithë kjo do të bëhet në përputhje me standardet e hapësirave të sigurta e mike për fëmijë. Do të krijohet një partneritet mes komunës dhe komunitetit duke krijuar ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative. Për t'i kthyer këto hapësira komunitare në hapësira përfshirëse, do të bëhet identifikimi i nevojave për rekreacion i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përfshirja e tyre në parqet ekzistuese.

### 4.5 Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin

Po aq me rëndësi është që fëmijëve t'u ofrohen mundësi që këtë kohë rekreacioni ta shfrytëzojnë për aktivitete që janë me përfitim për komunitetin. Kësisoj ata i zhvillojnë vlerat qytetare dhe përgjegjësinë për komunitetin. Komuna do të përkrah organizimin e kampeve me fëmijë dhe të rinj nga shkollat e ndryshme, por edhe atyre nga organizatat e fëmijëve. Këto kampe do të jenë të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. Do të organizohen vizita e takime edukative e kulturore në institucionet që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Më tutje, do të bëhet angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve në akvititete në përfitim të komunitetit si mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik, etj.

## OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre

Ne duam që fëmijët, në varësi të kapacitetit të tyre, të marrin pjesë aktivisht në vendimet për komunën, sidomos në ato që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre. Do të ndihmojmë edhe familjet që të ndjekin këtë qasje që nga fëmijëria e hershme, kurdo që vendoset për jetët e fëmijëve të tyre. Institucionet arsimore kanë një rol të madh në fuqizimin e fëmijëve në pjesëmarrje. Strukturave përfaqësuese të fëmijëve në nivele të ndryshme do t'u ofrohet hapësirë veprimi dhe përkrahje nga të rriturit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Organet vendimmarrëse në të gjithë sektorët e komunës do të ndjekin procedurat e konsultimeve me fëmijë para se të marrin vendime që ndikojnë në jetën e fëmijëve.

### 5.1 Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes

Do të përcaktohen procedurat për konsultimin e fëmijëve për të gjitha palët në komunë që marrin vendime për fëmijët dhe në përgjithësi për qytetarët e komunës. Këto procedura do të paraqiten përmes një udhëzuesi praktik. Do të monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë nga të gjithë sektorët komunalë me rastet e hartimit të projekteve zhvillimore, strategjive e planeve të veprimit, me rastin e planifikimit të buxhetit, etj.

### 5.2 Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve

Këshillat e nxënësve janë organe të nxënësve të parapara me ligj. Ndonëse ato janë të themeluara në të gjitha shkollat, funksionimi i tyre duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes dhe mandatin e angazhimit të tyre është larg prej standardeve të përfaqësimit demokratik. Prandaj, do të nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet, duke filluar nga këshillat e nxënësve nëpër klasa, e deri te Asambleja Komunale e Fëmijëve. Këto organe duhet të jenë gjithëpërfshirëse në kuptim të përfaqësimit gjinor, gjeografik, etnik, të aftësive, etj. Më tutje, do të zhvillohen kapacitetet e fëmijëve për pjesëmarrje demokratike në jetën shkollore dhe të komunitetit, përmes moduleve të trajnimit për udhëheqje e aktivizim qytetar. Një aspekt qenësor është rregullimi i marrëdhënieve në mes vetë nxënësve. Për këtë arsye do të promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë, por edhe në lagje. Do të identifikohen fëmijë që mund të angazhohen si ndërmjetësues dhe të trajnohen për aspekte të ndërmjetësimit në mes moshatarëve.

## OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë

Ne duam që i gjithë procesi i zbatimit të planit të punës të reflektojë qeverisjen e mirë dhe miqësore për fëmijë. Prandaj, është me shumë rëndësi që ky proces të jetë me pronësi të gjerë, ku të gjitha palët do të bashkërendojnë veprimet me qëllimin që të adresohen masat e definuara me planin e punës. Ndërsa, për të siguruar cilësinë na nevojitet zhvillimi i instrumenteve për vlerësimin e ndikimit në fëmijë, dhe hartimi i raporteve për gjendjen e fëmijëve të komunës.

### 6.1 Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve

I gjithë procesi i qeverisjes miqësore për fëmijë, i bashkërenduar përmes planit të punës ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit që ka në fëmijë. Prandaj, fillimisht do të realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimi të planit të punës. Pastaj, do të bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës. Raportet nga vlerësimi do të diskutohen në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikat e qeverisjes lokale.

### 6.2 Koordinimi me palët relevante

Qasja e bashkëpunimit me të gjitha palët, është parim i punës së qeverisjes komunale në përpjekjen për një komunë mike për fëmijë. Prandaj, do të mbajmë komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me palët e ndryshme si në nivelin lokal (me organizata, grupe joformale, bashkësi lokale, këshilla, etj.), ashtu edhe në nivelin rajonal e qendror (me institucionet qendrore/rajonale që ofrojnë shërbime në nivel komunal, por edhe me vetë qeverisjen qendrore) Kjo do të na ndihmojë që të sigurojmë politika të mira për fëmijët, si dhe të kërkojmë përkrahje shtesë nga niveli qendror për nevojat e fëmijëve të komunës.

### 6.3 Vlerësimi dhe raportimi

Plani i veprimit do t'i nënshtrohet vlerësimit periodik në baza gjashtëmujore, prej nga do të nxjerren raportet, të cilat do të shërbejnë për periudhat vijuese të implementimit. Ndërsa në fund të periudhës së zbatimit të planit trevjeçar do të bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të këtij plani dhe do të hartohet raporti i cili do të shërbejë si burim për planifikimin e planit të ardhshëm disavjeçar.

## PLANI I VEPRIMIT

| 0 | Objektiva strategjike |
|---|---|
| 0.0 | Masa |
| | Veprimi |

| 1 | Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë |
|---|---|
| 1.1 | Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë |
| | Bëhet ekzaminimi/evidentimi i shërbimeve ndaj fëmijëve në Komunë |
| | Zhvillohet katalogu i llojeve të shërbimeve komunale dhe ofruesve të shërbimeve |
| | Organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, mediave, rrjeteve sociale dhe ueb faqes së komunës |
| 1.2 | Ndarja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme |
| | Identifikohen nevojat për shërbime |
| | Kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijët (si: mallëra, ushqim, transport, etj.) |

| 1.3 | Përkrahja në ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative dhe dënimeve për fëmijë që kanë rënë në konflikt me ligjin |
|---|---|
| | Nënshkruhet një memorandum i mirëkuptimit në mes të Komunës dhe Shërbimi Sprovues |
| | Rritet komunikimi në mes të komunës dhe institucionit sprovues, për lehtësimin e procesit e adresimit të nevojave të fëmijëve në konflikt me ligjin |
| 1.4 | Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv |
| | Përshtaten modulet/praktikat ekzistuese të prindërimit të mirë për nevoja të komunitetit. |
| | Krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit (trajnim i trajnerëve), p.sh. psikologët në shkolla, edukatorët, profesionistët shëndetësorë, etj. |
| | Shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve/sesioneve informuese, dhe fletushkave informuese. |
| 1.5 | Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për ta regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën |
| | Bashkëpunohet me zyrën e regjistrimit civil dhe merren informata për të gjithë fëmijët e moshës shkollore të zonës |
| | Regjistrohen nxënësit duke respektuar rregulloren komunale |
| | Mirëmbahet baza e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit SMIA-s |
| | Funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) |
| | Bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim |
| 1.6 | Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla |
| | Trajnohen mësimdhënës për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike dhe psikosociale |
| | Krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale |
| | Identifikohen nevojat për mësimdhënës dhe asistentë mbështetës për fëmijët nxënës me nevoja të veçanta arsimore |

Punësohen mësimdhënësit dhe asistentë mbështetës për fëmijët nxënës me nevoja të veçanta arsimore

## 1.7 Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore

Angazhohen ekipe profesionale për inspektim të gjendjes së shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj.)

Inspektohen objektet shkollore në baza vjetore dhe hartohen raporte

Ndërmerren masa përmirësuese bazuar në raportet

Promovohen standardet për shkollat mike për fëmijë

## 1.8 Krijimi i makanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore

Vetëdijesohen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes së shkollës

Hartohet një udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore

Shpërblehen komunitetet më të vyeshme shkollore

## 1.9 Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit

Ndërmerret fushatë vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve

Organizohen ligjërata për edukimin shëndetësor dhe reproduktiv për nxënësit e shkollave, përmes sistemit të ligjëratave të profesionistëve shëndetësorë

Organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca

## 1.10 Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore nga QKMF për fëmijët, në baza periodike

Zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, për këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme.

Organizohen vizita shëndetësore në shtëpi për nënat dhe fëmijët

Zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal

Organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, me komponentin e intervenimit shëndetësor edhe atij edukativ.

Realizohen kontrollet sistematike shëndetësore nëpër Shkolla.

## 1.11 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me nevoja të veçanta

Përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta

Promovohen shërbimet institucionale dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijëve me nevoja të veçanta, me fokus në përfitimet e FNV dhe familjeve

Hartohet/përdoret dokumenti (formulari) për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë

Bëhen vlerësime i fëmijëve nxënës me nevoja të veçanta nga ekipi për vlerësimin pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe merren vendimi per të adresuar gjendjen tek organet përkatëse. rekomandohen masat që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit).

## 1.12 Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë

Subvencionohen organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim të bazuar në bashkësi, për fëmijët me aftësi të kufizuar

Identifikohen nevojat dhe sigurohet qasja fizike e fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësira publike

Ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cenueshme fëmijët në situatë rruge/lëmoshëkërkuesit, fëmijët që punojnë, fëmijët e trafikuar, etj., të tilla si mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.

Avancohet komunikimi ndërmjet palëve kryesore (Qendrës për Punë Sociale, Kujdesit Parësor Shëndetësor, Personelit Arsimor, Policisë, Gjykatës, Organizatave Joqeveritare, etj) për një referim dhe kujdes ndaj fëmijëve në nevojë

## 2 Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve

| 2.1 | Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve |
|---|---|

Ofrohen trajnimet për politikëbërësit dhe zyrtarët komunalë në fushën e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës

| 2.2 | Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët |
|---|---|

Planifikohen dhe organizohen fushatat vetëdijesuese dhe shpërndahet material promovues për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre

| 2.3 | Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës |
|---|---|

Përkrahet puna e organizatave joqeveritare, koalicioneve e rrjeteve që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve

Mundësohet dhe përkrahet puna e vetë strukturave organizative të fëmijëve dhe të rinjve

| 2.4 | Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias |
|---|---|

Ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyren komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatin e Ekipit dhe mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike

Përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale

Organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit të fëmijëve

| 3 | Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët |
|---|---|
| 3.1 | Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët |

Hartohen dhe realizohen projekte për lirimin e trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, sinjalizimi i shtigjeve të biçiklistëve etj.

Bëhet fushatë informimi me të gjithë pjesëmarrësit në trafik për sigurinë në trafik.

| 3.2 | Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik |
|---|---|

Promovohet linja telefonike për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër.

Menaxhohen/sistemohen qentë endacakë

Merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës (personat e paautorizuar, shitja e artikujve të dëmshëm, etj.)

Rritet sipërfaqja e hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.

## 4 Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit

### 4.1 Promovimi i sportit nëpër shkolla

Ngriten kapacitetet e përfaqësuesve të shkollave për promovimin e sportit shkollor

Krijohen/zhvillohen klubet sportive shkollore

Organizohen gara sportive në shkolla dhe mes shkollave

### 4.2 Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja

Nxitet rekrutimi i fëmijëve djem e vajza nëpër klube sportive

Mbështetet komunikimi në mes të klubeve, shkollave dhe prindërve

Organizohen kampe për identifikimin e talenteve në sporte

### 4.3 Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë

Nxitet themelimi/funksionimi i klubeve artistike e kulturore nëpër shkolla

Organizohen aktivitete të përbashkëta të klubeve artistike e kulturore të shkollave dhe të organizatave të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, etj.

Ofrohen më shumë hapësira nëpër shkolla e gjetiu që fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë teknologjike si: programim, kodim, ueb dizajn, etj.

### 4.4 Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

Inspektohen parqet ekzistuese dhe identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë

Intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja

Krijohen ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative

| 4.5 | Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin |
|---|---|

Organizohen kampe të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. për fëmijët e shkollave dhe organizatave të fëmijëve

Organizohen vizita e takime në institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut/fëmijëve

Angazhohen fëmijët dhe të rinjtë në aktivitete në përfitim të komunitetit (mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik)

| 5 | Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre |
|---|---|
| 5.1 | Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes |

Hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë që në fazat e hershme të proceseve vendimmmarrëse

Monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë

| 5.2 | Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve |
|---|---|

Nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet

Trajnohen përfaqësuesit e nxënësve për udhëheqje dhe aktivizim qytetar

Promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë

| 6 | Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë |
|---|---|

## 6.1 Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve

Realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimi të planit të punës

Bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës

Diskutohen raportet në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikat të qeverisjes lokale

## 6.2 Koordinimi me palët relevante

Mbahet komunikim e bashkëpunim sipas nevojës me palët e tjera në nivel qendror, lokal dhe në nivel të komunitetit

## 6.3 Vlerësimi dhe raportimi

Bëhet vlerësimi periodik (çdo 6 muaj) i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti

Bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti përfundimtar

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/343
Një. Org. 7
Nr. i faq. 1
Data 10/01/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

| | |
|---|---|
| Për/Za/To: | **z. Shpejtim Gacaferi** - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunen e Junikut. |
| Përmes/Prekto/Through: | **z. Ruzhdi Shehu** - Kryetar i Komunes së Junikut, Kryesues i Keshillit Komunal për Siguri në Bashkësi |
| Nga/Od/From: | **z. Besart Tofaj** - Nënkryetar i Komunes së Junikut, Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi |
| Datë/Datum/Date: | **10.01.2025** |
| Tema/Subjekat/Subject: | **Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal** – Shqyrtimi dhe miratimi i Planit te Punes së KKSB-së per vitin 2025. |

I nderuar,

Keshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në mbledhjen e mbajtur më datë 20 dhjetor 2024, ka shqyrtuar dhe miratuar Planin e Punes per vitin 2025.

Andaj, ju rekomandojme që Plani i Punes të shqyrtohet dhe miratohet nga Kuvendi Komunal i Junikut.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Plani i Punës për vitin 2025

## Hyrje

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

**Plani Vjetor i Punës së KKSB-së**, përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësive për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhezimin administrative për KKSB-në.

**Roli i KKSB-së** në komunën tonë është i rëndësishëm sepse grumbullon shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkesive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të komunës dhe të organeve të sigurisë dhe tentohet të zgjidhen në dobi të qytetarëve.
KKSB në Junik drejtohet nga kryetari i komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu në bashkëpunim të ngushtë me komandantin e policisë së Junikut z. Rasim Syla dhe në bashkëveprim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e bashkësive fetare myslimane, përfaqësues të organizatave jo qeveritare, të biznesit dhe ekipe për siguri publike në bashkësi, nën monitorim autoriteteve nacionale siç është Departamenti i Sigurise Publike dhe autoriteti i inspektoratit të policisë si dhe të organizatave të ndërkombetare si OSBE, KFOR dhe UN.
Nëpërmjet KKSB-së arrihet të kuptohen shqetësimet e të gjithë qytetarëve në komunën e Junikut dhe të ndërmerren hapa konkret për zgjidhjen e atyre problemeve. Duke qenë të bindur në rolin e rëndësishëm që ka KKSB, komuna e Junikut është në maksimum e përkushtuar që plani i punës së KKSB-së të zbatohet me përpikëri.
Çdo komunë është e obliguar të themelojë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. KKSB themelohet me vendim të kuvendit të komunës dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës. Mandati i KKSB-së është 4 vite dhe korrespondon me periudhën e mandatit të Kuvendit të Komunes. Në mënyrë që me sukses të kryej misionin e vetë, duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, KKSB duhet të përpilojë dhe ta miratojë planin e punës për vitin vijues. Pas miratimit të planit të punës nga vetë KKSB, plani prezantohet dhe shqyrtohet edhe në kuvendin e komunës përkatëse.

## Qëllimi i planit të punës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkesi nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara me këte plan, por do të jete aktiv edhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme dhe trajtimin e kërkesave të tyre të kësaj natyre. Plani i punes i KKSB-së ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së qytetarëve duke u kujdesur për problematika të cilat e prekin drejtpërdrejtë jeten e tyre. Plani i punës ofron qartësi në veprim, definon problematikat dhe afatet që do të trajtohen gjatë vitit, paraqet rezultatet e pritura, tregon se kush janë autoritetet përgjegjëse për të marrë masa në zgjidhjen e problemeve.

## Objektivat

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL KKSB duhet te mbaj së paku 6 mbledhje gjatë vitit. Në këto mbledhje shqyrtohen problem të cilat synojnë përmirësimin e sigurisë së qytetarëve. Duke u bazuar ne këto udhëzime, KKSB në Junik për vitin 2025, përveç mbajtjes së 6 mbledhjeve të obligueshme, synon që të shqyrtojë këto çështje të sigurisë.

### Aktivitetet

Për t' arritur këto objektiva, Anëtarët e KKSB do të ndërmarrin këto aktivitete:

1. Do të monitorojnë në vazhdimësi gjendjen e sigurisë në të gjithë territorin e komunës;
2. Do të mbledhin shënime, fakte dhe do të raportojnë në mbledhjet e KKSB-se për secilin problem të vëzhguar, dëgjuar apo supozuar;
3. Do të mbajnë takime me qytetarë, këshilla shkollore, grupe qytetarësh, organizata joqeveritare (OJQ) dhe do të dëgjojnë problemet e tyre;
4. Do të adresojnë problemet në organet kompetente, si dhe krijimin e partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi;
5. Do të mbajnë evidenca për problemet e shqyrtuara dhe për progresin e arritur në zgjidhjen e problemit.

## Rezultatet e pritura

Duke vepruar siç është cekur më sipër dhe duke u përqendruar në objektivat e shënuara më sipër situata do të ndryshojë në të mirë të qytetarëve. Për qytetarët do të sigurohet më shumë siguri në të gjitha fushat.

## PLANI I PUNËS SE KKSB-së PËR VITIN 2025

*Në formë tabelore paraqitet si:*

| Kategorizimi | Nr | Temat për shqyrtim | Bartësit | Periudha e raportimit |
|---|---|---|---|---|
| Shëndetësia | 1 | Paraqitja e gjendjes aktuale në Komunën e Junikut<br>Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Junikut.<br>Kodi i Etikës, personeli mjekësor - sjellja e mjekëve dhe asistentëve nëpër institucione dhe ordinanca mjekësore.<br>Gjendja me barna dhe material esenciale në QKMF. | Drejtori i QKMF-së – Junik;<br>Policia e Kosovës;<br>Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Junikut; | Shkurt |
| | 2 | Shëndeti tek nxënësit e Komunës së Junikut; | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Junikut;<br>Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport. | Shkurt |
| Kamerat e Qytetit | 3 | Kamerat e qytetit; | Informatë nga Policia e Kosovës; | Shkurt |
| Arsimi | 4 | Diskutim rreth vijeshmërisë së nxënësve në Komunën e Junikut; | Të përgatitet raporti nga Drejtori i DKA-së; | Prill - Tetor |
| | 5 | Mirëmbajtja e shkollave siguria në dhe për rreth objekteve shkollore. | Të raportohet nga Drejtori i DKA-së, këshilli i prindërve, psikologët e shkollave ose pedagogët; | Qershor |
| | 6 | Gjendja e shkollave sipas rezultateve të testit të arritshmerisë për klasat e 9-ta dhe Matures Shtetërore; | Të raportohet nga Drejtori i DKA-së, | Prill |
| Ambient | 7 | Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në komunën e Junikut, deponitë ilegale, mbeturinat; | Të ftohen në bashkëbisedim:<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Policia | Qershor |
| | 8 | Prerja ilegale e pyjeve,<br>Gjuetia e paligjshme,<br>Peshkimi i paligjshëm. | Drejtori për Zhvillim Ekonomik;<br>Agjencioni pyjor;<br>Drejtoria për Shërbime Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim, | Gusht |
| Mjedisi Urban | 10 | Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve;<br>Gjelbërimi; | Të ftohen në bashkëbisedim nga Kompania Rajonale për mirëmbajtjen e kanaleve,<br>Drejtori për Zhvillim Ekonomik,<br>Drejtoria për Shërbime Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim, | Shkurt - Tetor |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Siguria | 11 | Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore; | Të ftohen në bashkëbisedim nga Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim; AVUK; | Prill |
| | 12 | Zjarret fushore dhe malore, pengesat për qasje të zjarrfikësve; | Drejtori për Zhvillim Ekonomik; Drejtoria për Shërbime Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim; | Gusht |
| | 13 | Dëmtimi i shtëpive, vjedhja e gjësendeve, siguria në Komunën e Junikut; Qentë endacak; | Të ftohet në bashkëbisedim përfaqësuesit e institucioneve komunale si dhe autoritetet qendrore; Agjencioni i Veterinarisë; | Tetor |
| | 14 | Ri integrimi i personave të riatdhesuar; | Të ftohet në bashkëbisedim IOM dhe organizatat tjera që e trajtojnë këtë çështje, | Dhjetor |
| | 15 | Diskutim mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe menaxhimin e varrezave në Komunën e Junikut | Të ftohen në bashkëbisedim përfaqësues të bashkësive fetare në Komunën e Junikut, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport; Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim; | Gusht |
| | 16 | Siguria në trafik, parkingjet, sinjalizimi, sanimi i rrugëve dhe ndriçimi publik; | Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim; | Gusht |
| Të Drejtat e Njeriut | 17 | Mbrojtja e grupeve të margjinalizuara të cilët mund të privohen nga të drejtat themelore, | Të ftohen në bashkëbisedim institucionet, OJQ që merren me çështje të dhunës në familje dhe të ngjajshme; Drejtoria Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale; | Dhjetor |
| Raportimi dhe Plani i Punës | 18 | Raportimi në Kuvendin Komunal për aktivitet e zhvilluara nga KKSB-së për vitin 2025 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2026, | Raportim i vjetor të KKSB-së për vitin 2025. Hartimi i Planit të Punës për vitin 2026, | Dhjetor |

## Afati kohor

Plani i punes Janar deri më Dhjetor 2025.

## Përmbledhje

Ne këtë plan të punës janë paraqitur informacione për KKSB-në, aktet që e rregullojnë veprimtarinë e saj. Po ashtu është paraqitur qëllimi i planit të punës, objektivat e planit, aktivitetet që do të ndërmerren nga anëtarët e KKSB-së për t'i arritur objektivat si dhe janë paraqitur rezultatet e pritura dhe afatet kohore.

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT MUNICIPALITY OF JUNIK OPŠTINA JUNIK

# *PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2025*

| Muaji | Aktivitetet | Realizuesit | Pjesëmarrësit | Data e takimeve |
|---|---|---|---|---|
| SHKURT | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2024.<br>- Të ndryshme. | Komiteti për Kumuniete<br><br>Kryesuesi i Kuvendit | Në takimet e KKJ<br>OSBE<br>OJQ - të<br>ZKKK<br>Kordinatori rajonal – MPB Depertamenti per riintegrim dhe të tjerë. | **24.02.2025**<br>**E hënë**<br>**Ora 11** |
| MARS | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Angazhimi i Drejtorive të shkollave lidhur me fenomenet e paraqitura në rrjetët sociale dhe ndikimi I tyre tek nxënësit.<br>- Të ndryshme. | Komiteti për Komunitete;<br>Zyra e DAKRS – së, | | **25.03.2025**<br>**E martë**<br>**Ora 11** |
| PRILL | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Informatë nga Qendra për punë sociale mbi numrin e rasteve sociale në Komunë.<br>- Të ndryshme. | Komiteti për Komunitete;<br>Qendra për punë sociale-zyra e QPS | | **23.04.2025**<br>**E merkurë**<br>**Ora 11** |
| MAJ | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Informatë rreth aktiviteteve sportive dhe kulturore në Komunë.<br>- Të ndryshme. | Komiteti për Komunitete;<br>Drejtoria e Arsimit. | | **26.05.2025**<br>**E hënë**<br>**Ora 11** |
| QERSHOR | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteteve mujore te zyrës për/kërkesat e komunitetit.<br>- Të ndryshme. | Komiteti për Komunitete;<br>Ministria e Kthimit;<br>Kryesuesi i Kuvendit<br>ZKKK. | | **24.06.2025**<br>**E martë**<br>**Ora 11** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **K O R R I K** | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Informatë rreth suksesit të nxënësve në shkollën fillore dhe të mesme dhe Regjistrimi e nxënësve në shkollë fillore dhe të mesme për v. shk. 2025/26.<br><br>- Të ndryshme | Komiteti për Komunitete Kryesuesi i Kuvendit<br>DAKRS. | | **25.07.2025**<br>**E enjtë**<br>**Ora 11** |
| **G U S H T** | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Informatë rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-25<br>- Tëndryshme. | Komiteti për Komunitete; Zyra e DAKRS -së<br>Kryesuesi I Kuvendit<br>ZKKK. | | ***26.08.2025.***<br>***E marte***<br>***Ora 11*** |
| **S H T A T O R** | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Informatë nga zyra për buxhet dhye financa lidhur mePlanifikimin e buxhetit komunal për 2026.<br><br>- Të ndryshme. | Komiteti për Komunitete; Zyra e DAKRS -së<br>Kryesuesi I Kuvendit<br>ZKKK. | | **24.09.2025**<br>**E merkurë**<br>**Ora 11** |
| **T E T O R** | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Informatë rreth përgatitjeve për mbjelljet vjeshtore.<br>- Të ndryshme. | Komiteti për Komunitete;Zyra e zhvillimit ekonomik | | **24.10.2025**<br>**E premtë**<br>**Ora 11** |
| **N Ë N T O R** | - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.<br>- Aprovimi i Planit të punës për vitin 2025 si dhe hartimi i kalendarit për mbjatjen e mbledhjeve në vitin 2025.<br><br>- Të ndryshme. | Komiteti për Komunitete;<br>Kryesuesi I Kuvendit<br>Zyra e SHPI -së | | **24.11.2025**<br>**E hënë**<br>**Ora 11** |
| **D H J E T O R** | P U S H I M | | | |

**Kryesuese e Komitetit për Komunitete**
**Zejnep Gaxherri_________________**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| REFERENC-Ë: | Numër: 02-12/24 |
| PËR/ZA/TO: | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik |
| NGA/OD/FROM | Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A | 30.12.2024 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

**PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dymbëdhjetë (12) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 30.12.2024, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti,kryetrarin e Komunes së Junikut z.Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z.Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit, më pas konstatoi se në mbledhje marin pjesë të 9 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leonora Shehu AD,znj.Vjollca Qestaj DBF, z.Zenun Shala DUKM, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS.

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK
5. Ermelinda Llolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Llolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

**Rendi i ditës i paraparë**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shfyqëzimi i Vendimit me nr:02/22/24 për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore-pyjore dhe klasës së tyre, të miratuar me dt:31.10.2024 në Kuvendin e Junikut
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së takimeve të rregullta te Kuvendit Komunal për vitin 2025 / leximi i dytë/,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim,
6. Shqyrtimi për grandin e Përfomanncës Komunale (GPK) për vitin fiskal 2025 sipas përformancës së Komunës për vitin 2023,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores për transparencë të Komunës së Junikut 2024-2028,
8. Raportimi për organizimin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar, dhe Raporti i takimeve me Kryetarët e Këshillave Lokale,
9. Raporti i Planit të Intergritetit për vitin 2024,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025,
11. Pyetje nga anëtaret e Kuvendit, dhe

Të ndryshme.

Rendi i ditës miratohet me 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

Ne kete mbledhje mungojnë, z.Sadri Krasniqi-LDK, z. Alfred Gaxherri-LDK, znj. Lirjeta Shehu-LDK, z.Leonard Llolluni- AAK, znj. Festina Maloku-AAK dhe z.Lulzim Gacaferi LVV.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi. kërkesë nuk ka e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se kaluar u miratua.

3. Shfyqëzimi i Vendimit me nr:02/22/24 për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore-pyjore dhe klasës së tyre, të miratuar me dt:31.10.2024 në Kuvendin e Junikut

Arsyetimin e shfyqezimit te vendimt nr.02/22/24 e beri Kryesuesi i Kuvendit z.Shpejtim Gacaferi. Këërkesë tjetër nuk ka, e qes në votim shfuqëzimin e vendimit me nr.02/22/24, kush eshtë për? për 9 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se shfuqëzimi i vendimit u miratua,

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së takimeve të rregullta të Kuvendit Komunal, për vitin 2025 / leximi i dytë/,

Sqarimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2025 (leximi i dytë) e bëri kryesuesi i Kuvendit z.Shpejtim Gacaferi i cili nder të tjera ceki se plani i punës së kuvendit ka një ndryshim prej leximit të parë, e ajo është që muaji gusht 2025 te jetë pushim. Sqarim shtesë bëri edhe Kryetari Komunës z.Ruzhdi Shehu, i cili propozoj që muaji Gusht 2025 të jetë pushim edhe për Kuvendin, pasi që në ketë mënyrë e rrespektojmë ligjin e punës.

z.Dervish Bajraktari, përshendetje për të gjithë, sa i përket propozimit te kryetarit që muaji Gusht të jetë pushim, ne vetëm i kemi kryer tri vite te këtij mandati dhe në gusht kemi mbajtur mbledhje, dhe asnjë herë nuk na është thenë deri tani se jemi në kundërshtim të ligjit, dhe tani jemi në vitin e fundit të mandatit dhe na thuani se jemi në kundërshtim të ligjit, dhe kërkesa ime është që Kuvendi të mbajë mbledhje edhe ne Gusht siç kemi mbajtur deri tani, pra kemi mbajtur tri vite, kemi edhe ketë vit dhe për ketë mendoj se duhet te mbahet mbledhja edhe ne Gusht.

z.Zenel Maloku, përshendetje për të gjithë, unë po mendoj që nëse në gusht i vendoset çelsi Komunës ateherë duhet të ketë pushim, por kur komuna punon unë them qe pse te mos mbaj mbledhje edhe kuvendi? e ku dihet se ne gusht vijnë edhe bashkëatdhetarët, andaj unë propozoj që mbledhja të mbahet edhe në Gusht.

z.Xhemë Tofaj, u tha se është në kundërshtim të ligjit , për derisa deri sot nuk ke në kundërshtim të ligjit, mendoj se nëse e mbajmë mbledhjen në gusht nuk ka asgjë të keqe.

z.Ruzhdi Shehu, nuk  ka kurfar problemi edhe nëse e mbani mbledhjen në gusht por ligji i punës e parasheh që mbrenda vitit të ketë një muaj pushim e unë po propozoi që në mirëkuptim të ketë pushim edhe kuvendi, në të kundertën kjo është çeshtje e kuvendit, dhe kuvendi të vendos se a do të mbajë mbledhe apo do të ketë pushim.

z.Xhavit Velijaj, përshendetje për te gjithë, e mora fjalen pasi që më herët kam qenë anëtar i Kuvendit, dhe ndoshta ndimoj ne ketë ëeshtje, ne në mandatin kur unë kam qenë ne kemi mbajtur mbledhje edhe ne Gusht pasi që në atë kohë sipas ligjit nëse nuk mban mbledhje hiqet meditja, dhe kjo ka qenë arsyeja që kemi mbajtë mbledhje, por tani me ligj parashihet edhe nëse nuk mban mbledhje pagesa e mëditjes behet, andaj mendoj se edhe kuvendit duhet të ketë pushim ne Gusht siç e ka edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ka pushim në Gusht.

z.Shpejtim Gacaferi, në rregull, kemi dy propozime, e qes ne votim propozimim e parë, Plani i Punës me Gushtin pushim, kush është për? 3 vota për, ky propozim nuk kalon , atëherë e qes në votim propozimin e dytë për Gushtin të punohet, kush është për? në sallë prezent gjatë votimit

ishin 8 anëtar, dhe për ishin 5 vota , konstatoi se Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2025 u miratua me punë Gushtin .

5. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim,

Sqarimin dhe arsyetimin e listës se pergjithshme të pronave te paluajtshme që planifikohen të ipen në shfrytëzim e bëri z.Zenun Shala-Drejtor ne DUKM, i cili fillimisht i përshendeti te gjithë, e më pas e sqaroj ketë pikë te rendit të ditës, para anëtarëve të Kuvendit.

z.Zenel Maloku, mua po më intereson të di se sa sipërfaqe toke ka Komuna e junikut pronë publike , shoqërore

z.Zenun Shala, unë nuk e kam sipërfaqen e pronave në tansi por listen me prona e keni para, dhe aty mund te shikoni edhe se sa prona ka komuna e Junikut në pronësi, dhe sa prej tyne mendohet te ipen në shfrytëzim.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, unë e qes ne votim listen e pergithshme dhe listen e veçantë të pronave te paluajtshme në komunën e Junikut, kush është për? prezent në sallë janë 9 anëtarë, për janë 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se lista e përgjithshme dhe lista e veçantë e pronës së paluajtshme u miratua.

6. Shqyrtimi për grandin e Përfomanncës Komunale (GPK) për vitin fiskal 2025 sipas përfomances së Komunës për vitin 2023,

Sqarimin dhe arsyetimin e grandit te perfomances Komunale ne cilësinë e Kordinatorit të grupit te perfomances komunale e bëri z.Rrustem Pepshi- zyrtar i lart i IT_se, i cili fillimisht i përshendeti të gjithë, më pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të Kuvendit, grandin e përfomancës komunale për vitin (2023).

z.Dervish Bajraktari, fillimisht ju përgzoj për ketë grand të perfomances, kjo është pas tri viteve qeverisje, unë po du vetem me ju kujtuuar se gjatë qeverisjes se AAK_se komuna e Junikut është shpërblyer tri herë si komuna më e mirë.

z.Rrustem Pepshi, unë që nga viti 2009 jam kordinator i grupit të perfomances së Komunës së Junikut dhe e di se si bëhet kjo lojë, dhe kisha thënë që me perfomancë të mos bëhet politikë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores për transparencë të Komunës së Junikut 2024-2028,

Sqarimin dhe arsyetimin e rregullores per transparencë të komunës së Junikut 2024-2028 e beri znj.Leonora Shehu- drejtoreshë në AD, e cila fillimisht i përshendeti të gjithë të pranishmit dhe më pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve te kuvendit rregulloren për transparencë të komunës së Junikut 2024-2028.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes ne votim rregulloren për transparencë të Komunës së Junikut për vitin2024-2028, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rregullorja per transparencë të Komunes se Junikut 2024—2028 u miratua.

8. Raportimi për organizimin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale Gacafer, Qender, Pepsh dhe Bajraktar dhe Raporti i takimeve me Kryetarët e Këshillave Lokale

Edhe për organizimin e këshillave lokale Gacafer, qendër, Pepsh, dhe Bajraktar sqarim dhe aryetim bëri znj.Leonora Shehu-Drejtoreshë në AD.

z.Xhemë Tofaj, kur është mbajtur ky takim dhe kush është zgjedhur kryetar i këshillit sepse kryetar i këshillit zgjidhet me votë.

znj.Leonora Shehu, keshillat zgjidhen me votë, unë ju kam dërguar disa herë ftesa për mbajtje të takimit, takimi i fundit ka qenë me dt:03.10.2024, ku kanë marë pjesë 4 anëtar të komisionit, ku kemi caktuar daten e zgjedhjeve e që ishte me 17.10.2024, dhe me ketë datë ka perfunduar procesi.

z.Xhemë Tofaj, sa pjesmarrës kanë marrë pjesë në ketë mbledhje.

znj.Leonora Shehu, në mbledhje kanë marrë pjesë 22 persona.

z.Xhemë Tofaj, prej katër lagjeve kanë marrë pjesë vetem 22 persona.

znj.Leonora Shehu, sipas rregullores takimi është legjitim nëse në të marrin pjesë së paku 20 qytetar.

z.Xhemë Tofaj, unë jam apsolut kundër ketij organizimi, dhe sot është hera e parë se po dëgjoj se është mbajtur ky takim.

z.Shpejtim Gacaferi, unë kam provuar te ju kontaktoj disa herë, por në atë kohë keni qenë jasht shtetit dhe po ashtu kemi biseduar edhe me z.Zenel Maloku, edhe ky per shkaqe shendesore nuk ka mundur te marrë pjesë ne komision dhe siç tha drejtoresha, takimi është legjitim edhe pse pjesmarrja ka qen e vogel jo si herave tjera me nga 144 pjesëmarrës.

z.Zenel Maloku, unë për shkaqe shëndetësore nuk kam mundur të marr pjesë në ketë takim, dhe kam thenë se ashtu si ta vendosni edhe unë do ta pranoj, dhe në takimet e me hershem kemi than se takimi eshte i legjitimshem edhe me pjesmarrje e me se pakti te 20 qytetarve.

z.Xheme Tofaj, unë nuk po dua te bejë lojë fjalësh por unë nga 30.07.2024 nuk kam qenë në përendim nga kjo datë unë jam këtu në Junik, dhe jemi parë çdo ditë.

z.Zenel Maloku, a mundemi me e ditë se kush eshte zgjedhur.

z.Shpejtim Gacaferi, eshte zgjedhur znj. Shqipedona Shehu, dhe as që ka pasur kundërkandidat.

9. Raporti i Planit të Intergritetit për vitin 2024,

Sqarimin dhe arsyetimin e Planit të Intergritetit per vitin 2024 e beri z.Rrustem Pepshi ne cilesinë e kordinatorit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, kalojmë në pikën e rendit të ditës te radhës.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i planit te punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025,

Sqarimin dhe arsyetimin e planit të punes për Komitetin për Komunitete për vitin 2025 e bëri z.Shpejtim Gacaferi, Kryetar i Kuvendit.

z.Zenel Maloku, ne në ketë komitet jemi dakorduar që ti mbajmë 10 mbledhje mbrenda vitit 2025, dy muaj janë pushim muaji Janar dhe Gusht, e unë po kërkoj që kjo të ndryshoj pasi që ne dhjetor nuk mundemi te mabajmë mbledhje, pasi qe pritet te ketë zgjedhje, mbledhjen e paraparë të dhjetorit 2025 ta mbajmë në janar 2025, kjo edhe është votuar ne ketë komitet dhe 4 vota kanë qenë për.

z.Shpejtim Gacaferi, plani i punës është çështje e komitetit në ketë rast dhe aty është paraparë që Janari dhe Gushti të jenë pushim, kështu na ka ardhë neve ky dokument, kuvendit i mbetet të votoj ketë dokument kështu siç është, sepse ndryshime ne te nuk na takon neve por vetëm Komitetit për Komunitete.

z.Dervish Bajraktari, z.Maloku po thot se ky ndryshim edhe është votuar ne komitet që mbledhja e Dhjetorit 2025 të zhvendost në Janar 2025, mos ka ardhë në kuvend me gabim ky plani i punës.

z.Shpejtim Gacaferi, meqë kuvendit nuk i takon që ta ndryshoj ketë dokument, unë po propozoi që plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025 të shtyhet për miratim në Janar 2025, komiteti ti bejë ndryshimet dhe të na bije planin e punës në mbledhjen e Janarit për miratim, kush është per? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i punës se komitetit për komunitete u shtye për Janar 2025.

11. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,

Nuk pati pyetje

12. Të ndryshme,

z.Dervish Bajraktar, unë i kam disa çeshtje, e para, në mbledhjen e fundit të KPF, na keni shpalosur pak projektin për Qendrën e Junikut dhe ne kemi kërkuar që ketë projekt të na prezentoni edhe në Kuvend, projekti i qendrës së komunës së Junikut keni pasur premtim, keni

ndarë edhe mjete buxhetore dhe ende nuk ka filluar asgjë, ende asgjë nuk ka dalë publike, jemi në mbledhjen e fundit për vitin 2024 dhe po kalojnë tri vite qeverisje, gjithashtu e keni pasur si premtim elektroral ujin e pijes për Lagjen “Agim Ramadani” dhe nuk keni berë asgjë deri tani, përpos që keni vendosur dy kroje, dhe thuani se analizat e ujit të pijes janë mirë, a deri sa në pushtet ishte AAK thoshit se analizat e ujit të pijes nuk janë mirë, a uji është i njëjtë edhe tani, çeshtja tjetër ka të bejë me tenderin për zbukurimin e qendrës për festat e fund vitit, a ka pasur tender? Dhe a ka mare dikush ketë tender? Sepse ne deri tani nuk kemi pasur asgjë, kemi një zbukurim që është për marre, çeshtja tjetër ka të bejë me mirëmbajtja e rrugëve gjatë dimrit a ka tender, a e ka mar dikush a si eshte gjendja, sepse ka disa qytetar qe kane dale ti pastroj rruget nga bora dhe kane thene se kane dalur ne menyre vullnetare.

z.Ruzhdi Shehu, sa i përket projektit të qendrës se Juniku, projekti është në detaje, nuk është i perfunduar dhe është te proqes te përfundimit, sa i përket furnizimit me ujin e pijes ne lagjen “Agim Ramadani” ne ju kemi drejtuar me kërkesë kompanis “Hidrodrini”, ata janë përgjegjës, analizat e ujit nuk i bëjmë ne, është instituti i shëndetit publik që benë analizat e ujit të pijes, ndërsa sa i përket zbukurimit të qendrës për festat e fundvitit, ne kemi pas një tender në vlerë prej 6000€ e diçka eurove, dhe ka pasur vetëm një operator ekonomik që ka aplikuar dhe e ka fituar, nuk ka pasur asnjë tjetër, edhe përkunder asaj që dy here e kemi qitur në tender.

z.Zenel maloku, po ju drejtohem juve kryetar, ka drejtor ketu që ka thënë se uji i lagjes “Agim Ramadani” është i pishëm, por unë po ta them se ka nganjeherë se rrobat nuk mundemi me i pastruar me atë ujë lëre me me e pi, andaj mos u bazo në këto analiza, sepse më mirë ndonjëherë më thenë nuk po muj ta bi ujin në lagje, apo nuk kemi mjete financiare, apo nuk i ka ardhur koha akoma, kjo do ishte më e ndershme.

z.Dervish Bajraktari sa i përket ujit të pijes në lagjen “Agim Ramadani” ne nuk jemi kundër, por ne jemi të votuar nga qytetarët dhe qytetarët kane këto kerkesa, kto kërkesa i adresone tek ju permes neve si te zgjedhur të tyre, ka edhe kërkesa tjera, por mua po më dhemb se u kryen tri vite te ketij mandati qeveritar dhe nuk keni mundur ta bëni dhe nëse mendoni se do ta kryeni në fundin e vitit të mandatit tuaj, ketë harro sepse nuk ke me mundur ta bëni, edhe nuk mu pergjigjet për pyetjen qe pata më herët që është në lidhje me tenderim mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit të dimrit desha të di a ka përfitues të këtij tenderi.

z.Ruzhdi Shehu, tenderi është ne proqes të ankesave, por edhe përkundër kesaj, te gjitha rrugët jane të pasturara nga bora.

z.Zenel Maloku, unë vetëm deshta të ju uroj vitin e ri 2025, jemi qytetar të kësaj komune dhashtë zoti të gjithë të kene një jetë të mirë dhe të mos ju ndodhë asnjë e keqe, por sa i përket tederit për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonit të dimrit do ishte mirë që ky tender të kryhej para se të vinte dimri.

z.Xhemë Tofaj, të ndryshme më lejohet që të kthehem edhe një herë te zgjidhja e këshillave lokale, në këto zgjedhjet e fundit thatë se është zgjedhur znj.Shqipëdona Shehu me 22 vota, a këtu keni të zgjedhur me 70 vota.

znj.Leonora Shehu, ka qenë vetëm zgjedhja e kryetarit për keshillin Lokal,anëtarët mbesin po të njejtit.

z.Dervish Bajraktari, edhe unë po i bashkohem urimit të z.Maloku, urime e sukese në vitin 2025, shijoni këto karrike edhe për një vit.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli te mbyllur mbledhejn e Dhjetorit 2025.

| | |
|---|---|
| Procesmbajtësi: | Kryesuesi i Kuvendit: |
| z. Esat Hoxha | z. Shpejtim Gacaferi |
| _______________ | __________________ |

# REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

## KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

| | |
|---|---|
| Referencë: | **Numër: 02/180/01/25** |
| Për/Za/To: | **Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut** |
| Nga/Od/From: | z. Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut |
| Datë/Datum/Date: | 06.01.2025 |
| Tema/Subjekat/Subject: | **R A P O R T  P U N E** |



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

**://rks-gov.net/junik**

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut

Lloji i punës: Raport pune

**“RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2024”**



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

**://rks-gov.net/junik**

Junik, janar 2025

Kuvendi i Komunës së Junikut në përputhje me obligimet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Junikut, Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe ligjet e tjera në Republikën e Kosovës, për vitin 2024 harton këtë:

# RAPORT P U N E

**Kuvendi i Komunës së Junikut është organi më i lartë i themeluar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 35).**

Kjo është legjislatura e pestë e këtij organi e dalë nga zgjedhjet lokale 2021.

Kuvendi i Komunës së Junikut numëron gjithsejtë 15 anëtarë prej të cilëve 9 janë meshkuj dhe 6 femra. Në kuvend janë të përfaqësuara tri subjekte politike: LDK me 6 këshilltarë; AAK me 6 këshilltarë dhe LVV me 3 këshilltarë

Përveç Kuvendit si organ ligjvënës në kuadër të tij janë të themeluara edhe trupa ndihmës siç janë komitetet dhe komisionet. Deri më tash janë të themeluara dy komitete obligative (dy të përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) , Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, 3 komitete jo obligative: Komiteti Konsultativ per Persona me Aftesi te Kufizuara , Komiteti per Sherbime Publike dhe Komiteti i Auditimit , po ashtu janë formuar edhe disa komisione ad-hoc, janë zgjedhur kryetaret e keshillave lokale gjithsejtë kater (4), grupi punues per hartimin e planit te punes se Kuvendit per vitin 2025.

Mirëpo për të gjitha çështjet tjera siç janë dërgimi i materialit, arkivimi si dhe evidentimi protokollar i të gjithë materialit të kuvendit është punuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke respektuar aq sa ka qenë e mundur Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024.



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

**://rks-gov.net/junik**

**TRAJNIMET DHE PUNTORITË**

**Gjatë vitit 2024 antaret e Kuvendit Komunal kanë pasur shumë takime njoftuese / trajnime/ qe lidhen me punen e Kuvendit të cilat kanë qenë të pergaditura nga Ministritë dhe Organizatat e ndryshme me qellimin që anëtaret e Kuvendit të jenë sa me te njoftuar për punën në Kuvend.**
**Kryesishtë keto trajnime kanë qenë te pergaditura dhe organizuara nga OSCE, Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal, HELVETAS dhe DEMOS organizata jo qeveritare.**
**Po ashtu ka pasur disa takime te organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosoves ku Kuvendi Komunal i Junikut ka qenë i perfaqesuar nga Kryesuesi i KK Junik.**

Gjatë vitit 2024 Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje të rregullta dhe dy (2) mbledhje solemne (17 Shkurti Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, dhe 13 Qershori dita e Çlirimit të Junikut) .

Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunën e Junikut.

Komitetet e përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2023 kanë mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje të rregullta sipas planeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut, Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsejtë 10 mbledhje të rregullta, kurse Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjithsejtë 6 mbledhje të rregullta, Komiteti Konsultativ per Persona me Aftesi te Kufizuara ka mbajtur gjithsejtë nje (1) mbledhje, Komiteti per Sherbime Publike nuk ka mbajtur mbledhje, ndersa kryetarët e Keshillave Lokale kan mbajtur nje (1) takim me kryesuesin e kuvendit komunal.

Puna e komisioneve të ngritura nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut do të pasqyrohet në raportin e punës së secilit komision veç e veç.

## RREGULLORET:

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2024 ka miratuar gjithsejtë 5 rregullore ( plotesim – ndryshime).



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

**://rks-gov.net/junik**

1. Rregulloret e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut në vitin 2023 janë:

    1.1. Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025
    1.2. Rregullorja ( plotësim – ndryshim ) për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.
    1.3. Rregullorja Strategjia Komunale kunder dhunes në familje 2024-2027.
    1.4. Rregullore Strategjia për komunikim dhe marëdhenje me publikun 2024-2026

**BUXHETI:**

**I.** Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2023 ka qenë **2,340,124,00 €**, dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Paga dhe mëditje: .........................**1,560,842.00 €**,
2. Mallra dhe shërbime: ..................... **274,860.00 €**,
3. Shpenzime komunale: ................... **42,950.00 €**,
4. Subvencione dhe transfere: ......... **70,000.00 €**,
5. Investime kapitale: ......................... **391,490.00 €**.

Përveç kësaj gjatë vitit 2024 Kuvendi i Komunës së Junikut ka nxjerrë gjithsejtë 33 akte prej të cilave të gjitha janë vendime. Nuk ka nxjerrë asnjë rekomandim dhe asnjë njoftim për arsye se për të njëjtat nuk është bërë asnjë kërkesë.
Nga te gjitha keto akte nje nuk është aprovuar dhe është kthyer nga Ministria e linjes si rekomandim Kuvendit per anulim të Vendimit , dhe nje Vendim per permiresim te preambules.

Në vijim në mënyrë tabelore po paraqesim aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2023.



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

**://rks-gov.net/junik**

## AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2024

| Nr. | Emërtimi | Numri i vendimit | Data e vendimit | Data e miratimit | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 01 | Vendimi për miratimin e Raportit të punës së kuvendit për vitin 2023. | 02/01/24 | 31.01.2024 | | |
| 02 | Vendim për miratimin e Raportit të punës të KKSB-së për vitin 2023 | 02/02/23 | 31.01.2024 | | |
| 03 | Vendimi për miratimin e Strategjisë Komunale kunder dhunës në familje 2024-2027. | 02/03/23 | 31.01.2024 | | |
| 04 | Vendim per miratimin e Rapoprtit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2023. | 02/04/24 | 29.02.2024 | | |
| 05 | Vendim per miratimin e Raportit të punës të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuarapër vitin 2023 | 02/05/24 | 29.02.2024 | | |
| 06 | Vendimi për miratimin e Planit të Punës të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2024. | 02/06/24 | 29.02.2024 | | |
| 07 | Vendimi për ndryshimin e Planit të Buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2023 sipas programeve. | 02/07/24 | 30.04.2024 | | |
| 08 | Vendimi për lirimin nga pozita e anëtares së KKSB-së të z. Xhevahire Krasniqi. | 02/08/24 | 30.04.2024 | | |
| 09 | Vendim për plotësimin e KKSB-së me një anëtare. | 02/09/24 | 30.04.2024 | | |
| 10 | Vendim për miratimin e Raportit të punës të Komitetit për Saherbime Publikepër vitin 2023. | 02/10/24 | 30.04.2024 | | |
| 11 | Vendim për miratimin e Raportit vlerësues të demeve të shkaktuara nga erërat në Komunën e Junikut . | 02/11/24 | 30.04.2024 | | |
| 12 | Vendim për fillimin e hartimit të projekt | 02/12/24 | 31/05/2024 | | |



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

://rks-gov.net/junik

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale. | | | | |
| 13 | Vendim për fillimin e hartimit të projekt rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme. | 02/13/24 | 31.05.2024 | | |
| 14 | Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027. | 02/14/24 | 28/06/2024 | | |
| 15 | Vendim për miratimin e Strategjisë Komunale për komunikim dhe marëdhenje me publikun 2024-2026. | 02/15/24 | 28.06.2024 | | |
| 16 | Vendim për lirim nga mandati i anëtarit të KKSB-së të z. Xhavit Gaxherri. | 02/16/24 | 31.07.2024 | | |
| 17 | Vendim për plotësimin e anëtarit të KKSB-së. | 02/17/24 | 31.07.2024 | | |
| 18 | Vendim për miratimin e Projekt Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2025 (leximi i parë). | 02/18/24 | 30.08.2024 | | |
| 19 | Vendim për miratimin e buxhetit për vitin 2025 të Komunës së Junikut. | 02/19/24 | 27.09.2024 | | |
| 20 | Vendim për themelimin e grupit punues të punës së Planit të punes per vitin 2025. | 02/20/24 | 27.09.2024 | | |
| 21 | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2025. | 02/21/24 | 31.10.2024 | | |
| 22 | Vendim për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore – pyjore dhe klasës së tyre. | 02/22/24 | 31.10.2024 | | |
| 23 | Vendim për Shqyrtimin Publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Junikut 2024-2032. | 02/23/24 | 26.11.2024 | | |
| 24 | Vendim për caktimin e normave tatimore për | 02/24/24 | 26.11.2024 | | |



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

**://rks-gov.net/junik**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | tatimin në pronën e paluajtshme pëe vitin 2025. | | | | |
| 25 | Vendim për lirimin nga detyra e anëtarit të KKSB-së. | 02/25/24 | 26.11.2024 | | |
| 26 | Vendim për plotësimin e anëtarit të KKSB-së. | 02/26/24 | 26.11.2024 | | |
| 27 | Vendim për fillimin e procedurave për hartimin e planit Komunal për Energji dhe Klimë. | 02/27/24 | 26.11.2024 | | |
| 28 | Vendim për fillimin e procedurave për hartimin e planit për Trashegimi Kulturore 2025-2030. | 02/28/24 | 26.11.2024 | | |
| 29 | Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të komunës së Junikut dhe orarit për vitin 2025 ( leximi i parë). | 02/29/24 | 26.11.2024 | | |
| 30 | Vendim për shfuqizimin e vendimit të kuvendit komunal të komunës së Junikut Nr. 02/22/24 ( për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore- pyjore dhe klasës së tyre). | 02/30/24 | 30.12.2024 | | |
| 31 | Vendim për miratimin e planit të punës së kuvendit dhe orarit të mbajtjes së takimeve për vitin 2025. | 02/31/24 | 30.12.2024 | | |
| 32 | Vendim për miratimin e listës së përgjithshme të pronave publike dhe listës së veçantë që planifikohen për dhenje me qera. | 02/32/24 | 30.12.2024 | | |
| 33 | Vendim për miratimin e rregullores për transparencë të Komunës së Junikut. | 02/33/24 | 30.12.2024 | | |

**Përfundim:**

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, por kurrsesi nuk mund ta konsiderojmë si të plotë, pasi që nuk kanë mundur



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

**://rks-gov.net/junik**

të pasqyrohen edhe aktivitetet e trupave ndihmës të Kuvendit të Komunës së Junikut për shkak të mungesës së raporteve të punës së tyre vitin 2024 të cilat pas hartimit duhet t'i prezantohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

Përfundimisht Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2024 ka funksionuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke u ballafaquar me probleme si të natyrës teknike (logjistike) ashtu edhe të natyrës ligjore dhe bashkëpunimit me ekzekutivin sa u përket respektimit të procedurave ligjore lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike komunale.

Me këtë rast në emër të Kuvendit të Komunës së Junikut Ju falënderoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut për kontributin e dhënë deri më tash.

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim Gacaferi ___________

kryesues



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947

://rks-gov.net/junik

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/342
Një. Org. 1
Nr. i faq. 3
Data. 10/01/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

| | |
|---|---|
| Për/Za/To: | **z. Shpejtim Gacaferi** - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut. |
| Përmes/Prekto/Through: | **z. Ruzhdi Shehu** - Kryetar i Komunës së Junikut, Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. |
| Nga/Od/From: | **z. Besart Tofaj** - Nënkryetar i Komunës së Junikut, Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. |
| Date/Datum/Date: | **10.01.2025** |
| Tema/Subjekat/Subject: | **Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal** – Raporti i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024. |

I nderuar,

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, si trupë ndihmëse e Kuvendit Komunal të Junikut, është i obliguar të raportojë për punën e tij gjatë vitit paraprak, në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi.

Për këtë arsye, bashkangjitur gjeni Raportin e Punës së KKSB-së për vitin 2024, të cilin kërkojmë të shqyrtohet nga Kuvendi Komunal i Junikut.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Kuvendi i Komunës së Junikut,
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi,
10 Janar 2025.

# Raporti i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut, gjatë vitit 2024 ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje të rregullta, ashtu siç është e paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut në gjashtë takimet që ka mbajtur ka përfshirë të gjitha temat që kanë qenë të planifikuara në planin e punës për vitin 2024, ku vlerësojmë që plani i punës është realizuar me sukses, dhe pjesëmarrja dhe angazhimi në diskutim të shumë qështjeve nga anëtarëve të këtij këshilli ka qenë shumë e mirë.

Në vijim ju paraqesim punën për secilin nga gjashtë takimet e mbajtura.

**Takimi 1**, datë 31 Janar 2024

Çështjet kryesore të diskutuara:

**Gjendja e sigurisë:** Situata e sigurisë u raportua si e qetë dhe stabile.
Reshjet e borës dhe erërat e forta shkaktuan disa dëme minimale; këto u evidentuan nga një komision komunal për t'u adresuar më pas në nivel qendror.
Vëmendje e veçantë iu dha furnizimit me energji elektrike dhe riparimit të kabllove të dëmtuara.

**Gjendja në QKMF:** QKMF funksionon 24/7, duke ofruar shërbime edhe për banorët e fshatrave përreth.
Gjendja me barna dhe materialet mjekësore është e mirë dhe pa probleme.
Kemi ofruar sherbime qe lehtëson vizitat shtëpiake për të moshuarit dhe gratë shtatzëna.

**Arsimi dhe infrastrukturat shkollore:** Gjendja në shkolla është e qëndrueshme, me fokus në mirëmbajtjen dhe sigurinë infrastrukturore.
Uniformat shkollore janë planifikuar për Shkollën Fillore për të nxitur barazinë mes nxënësve.

**Strategjia kundër dhunës në Familje:** Komuna ka miratuar një strategji që përfshin mekanizma mbështetës dhe trajtime për rastet e dhunës në familje.

**Takimi 2.** datë 28 Mars 2024

Çështjet kryesore të diskutuara:

**Gjendja e sigurisë:** Situata e sigurisë u raportua e qetë, me vetëm 3 raste penale në tremujorin e fundit. Janë shqiptuar rreth 200 gjoba në trafik, kryesisht për tejkalim të shpejtësisë. Nuk u raportuan aksidente në trafik për këtë periudhë.
Planifikime për masa shtesë ndaj dukurive të tilla si zjarrvëniet, përdorimi i substancave narkotike dhe hedhja ilegale e mbeturinave.

**Mirëmbajtja e shkollave dhe shëndeti i nxënësve:** Siguria në shkolla është vlerësuar e lartë, me sisteme kamerash të instaluara dhe një punëtor teknik shtesë të angazhuar.
Planifikimi për vizita mjekësore për nxënësit e klasave 1-9 në muajin Prill.
U diskutua për nevojën e rrethojave të reja dhe parkingjeve në shkollë, si dhe për fushata vetëdijësimi mbi shëndetin e nxënësve.

**Deponitë ilegale dhe menaxhimi i mbeturinave:** Komuna ka caktuar një deponi për mbeturinat inerte dhe ka shqiptuar disa dënime për hedhje ilegale. U theksua rëndësia e parandalimit të eksploatimit të lumenjve nga kompanitë e gurthyesve.
Diskutime për përfshirjen e të rinjve në aktivitete që parandalojnë emigrimin.

**Çështje të tjera:**
Propozim për krijimin e një objekti për kurse të gastronomisë dhe përgatitjes së ushqimeve, duke pasur parasysh zhvillimin e turizmit në bjeshkë.

**Takimi 3**, datë 26 Qershor 2024

Çështjet kryesore të diskutuara:

**Gjendja e sigurisë:** Situata e sigurisë u raportua e qetë, me 6 raste penale të ndriçuara plotësisht.
Janë shqiptuar rreth 200 gjoba në trafik, kryesisht për tejkalim të shpejtësisë.
U diskutuan masat për sezonin veror, përfshirë menaxhimin e parkingjeve dhe fushatat vetëdijësuese.
Nuk ka pasur raste që dëmtojnë sigurinë publike.

**Prerja iegale e pyjeve dhe menaxhimi i mjedisit:** Kompetencat për menaxhimin e pyjeve janë transferuar në Agjencionin Pyjor të Kosovës.
Prerjet ilegale janë zvogëluar, por incidente sporadike u raportuan në disa zona.
U theksua nevoja për bashkëpunim ndërinstitucional për ruajtjen e pyjeve dhe parandalimin e ndërtimeve ilegale në bjeshkë.

**Çështje të tjera:**
U diskutua zbatimi i një projekti për trajtimin e kancerit të gështenjave.
U theksua rëndësia e rregullimit të sinjalistikës rrugore dhe pastrimit të rrugëve nga drunjtë.
Kërkesa për ripozicionim të sinjaleve rrugore në disa rrugë.

**Takimi 4**, datë 30 Shtator 2024

Çështjet kryesore të diskutuara:

**Gjendja e sigurisë:** Gjendja e sigurisë u vlerësua si e qetë. U raportuan pesë raste gjatë shtatorit, nga të cilat tri ishin vepra penale. Policia ka marrë masa parandaluese, përfshirë ndalimin e tre personave. Trafiku gjithashtu u raportua si i qetë, me një aksident të vogël dhe 70 tiketa për shkelje të trafikut.

**Arsimi:** Gjendja në shkolla është e mirë, me përgatitje të plota për vitin e ri shkollor.
Në testet e maturës dhe arritshmërisë, kalueshmëria ishte përkatësisht 97% dhe 100%.
Është ndaluar dalja e nxënësve nga shkollat gjatë mësimit për të rritur sigurinë.

**Shërbimet publike:** U diskutua për furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimin, ndriçimin publik dhe menaxhimin e mbeturinave.
U theksua nevoja për ndërhyrje më të mëdha për mirëmbajtjen e rrugëve dhe zgjerimin e sinjalizimit rrugor.

**Siguria në trafik:** U përmendën mungesat e sinjalizimit horizontal dhe shenjat për kufizim shpejtësie në disa rrugë, duke përfshirë rrugen për Dobrosh.
U theksua nevoja për ndërhyrje në këtë drejtim për të siguruar lëvizjen e sigurt të qytetarëve.

**Çështje të tjera:**
U diskutua për qentë endacakë dhe nevoja për zgjidhje të qëndrueshme në nivel qendror.
Mirëmbajtja e varrezave komunale dhe shqetësimet për gjendjen e tyre.
Problem i hedhjes ilegale të mbeturinave dhe përmirësimi i ndriçimit në rrugë të caktuara.

**Takimi 5**, datë 21 Nëntor 2024

Çështjet kryesore të diskutuara:

**Gjendja e sigurisë:** Policia raportoi për tre raste kryesore: dhunë në familje, gjetje të një mjeti të pashpërthyer dhe një aksident trafiku pa viktima. Gjendja e përgjithshme u vlerësua si e qetë.
Policia ka nisur përgatitjet për sezonin dimëror dhe theksoi rëndësinë e pajisjeve dimërore për automjetet.

**Fushata kundër dhunës në familje:** Në bashkëpunim me KLSP-në dhe Zyrën e Barazisë Gjinore, u organizua një fushatë gjashtëmbëdhjetë ditore me ligjërata në shkolla. Kjo fushatë synon të rrisë ndërgjegjesimin mbi dhunën në familje.

**Kujdesi për të moshuarit dhe viktimat e dhunës në familje:** Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale raportoi për vizita të rregullta në shtëpi për të moshuarit dhe ata me nevoja shëndetësore, me rreth 2760 vizita deri në tetor 2024.
Një marrëveshje me strehimoren në Pejë siguron kujdes të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje.

**Çështje të tjera:**
U diskutua për nevojën e formimit të një liste të vullnetarëve të trajnuar dhe të certifikuar për reagime emergjente.

U raportua per dëmtime të lodrave në hapësira publike, me shpresën se instalimi i kamerave të sigurisë do të ndihmojë në parandalimin e rasteve të tilla.

**Takimi 6,** datë 20 Dhjetor 2024

Çështjet kryesore te diskutuara,

**Gjendja e sigurisë:** Policia raportoi për një situatë të qetë në Komunën e Junikut, duke theksuar se monitorimi i kamerave të sigurisë ka lehtësuar ndjeshëm punën e tyre.
Gjithashtu, u vlerësua bashkëpunimi i mirë mes Policisë dhe qytetarëve për çështjet e sigurisë publike.

**Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2025:** U miratua Plani i Punës për vitin 2025 nga anëtarët e KKSB-së.

**Riintegrimi i personave të riatdhesuar:** U raportua për situatën e personave të riatdhesuar dhe për shërbimet që Komuna e Junikut mund të ofrojë për ta, duke përfshirë mbështetje në integrimin e tyre në komunitet.

**Informatë nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Junik:** Anëtarët e KKSB-së u informuan nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në lidhje me ndryshimet në ligjin për zgjedhjet. Anëtarëve iu kërkua që këto informata t'i shpërndajnë tek komunitetet që përfaqësojnë, për të siguruar një informim të gjerë dhe korrekt.

**Çështje të tjera:**
U diskutua çështja e monitorimit të kamerave të sigurisë në qytet nga ana e Policisë së Kosovës, me qëllim përmirësimin e sigurisë publike dhe parandalimin e incidenteve.

Gjatë vitit 2024, Keshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut ka mbështetur realizimin e fushatave vetëdijesuese dhe ka shprehur gatishmërinë për të diskutuar dhe mbështetur fushata të ngjashme edhe në të ardhmen. Këto përpjekje përfshijnë thirrje për sensibilizim të përbashket, veçanërisht për çështjet që lidhen me sigurinë publike.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, ka zëvendesuar dy anëtare te këtij këshilli të cilët kishin dhënë dorëheqje gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, raporti i punës për vitin paraprak është dorëzuar në Kuvendin Komunal, siç parashihet me udhëzimin administrativ përkatës.

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

# KOMUNA E JUNIKUT

# RAPORTI I BUXHETIT KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR/ 2024

**Junik, Janar -2025**

# Informata -IV- Financiare Periodike 2024

## Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Dhjetor 2024, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 "Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë" dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.
Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK ( Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor

## TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare te Kontabilitetit ne Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme". Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Junikut. Komuna e Junikut kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e saja financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Junikut nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Junikut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i aprovuar në Asamblenë Komunale për vitin 2024 është në vlerë **2,199,836.93€** i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2023 në vlerë **2,469.85€,** Bartja e te hyrave të pashpenzuara të vitit 2023 të bartura për shpenzim në vitin 2024 në shumë prej **147,963.74€** Me vendim të qeverise nr. 03/239 të datës 24.12.2024 për harmonizime te brendshme është rritur kategoria e pagave **26,282.49€** . Buxheti përfundimtar i përgjithshëm duke përfshirë edhe donacionet është në vlerë **2,376,553.01€.**

## Raport i ekzekutimit të Buxhetit

| | | Buxheti fillestar | Buxheti Aktual | Pranimet - Alokimet | Pagesat (Shpenzimi) | Progresi me plan | % me alokim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përshkrimi | | Ligji Nr. 08-L-260 | SIMFK | SIMFK | | në, % | në, % |
| a | | b | c | d | e | f =e/c | g =e/d |
| **Gjithsej Pagesat** | | **1+2+3+4+5** | **1+2+3+4+5** | **1+2+3+4** | **1+2+3+4+5** | | |
| **Totali** | | **2,199,836.93** | **2,376,553.01** | **2,324,784.49** | **2,219,237.82** | **93.38%** | **95.46%** |
| Paga dhe Meditje | | **1,445,892.93** | **1,472,175.42** | **1,472,175.42** | **1,472,175.42** | **100.00%** | **100.00%** |
| Mallrat dhe Shërbimet | | **246,660.00** | **284,361.80** | **284,361.80** | **268,041.06** | **94.26%** | **94.26%** |
| Shpenzimet Komunale | | **38,500.00** | **38,500.00** | **38,500.00** | **38,492.87** | **99.98%** | **99.98%** |
| Subvencione dhe Transferet | | **62,000.00** | **62,400.00** | **62,400.00** | **56,892.49** | **91.17%** | **91.17%** |
| Investimet Kapitale | | **406,784.00** | **519,115.79** | **467,347.27** | **383,635.98** | **73.90%** | **82.09%** |
| **Granti i Përgjithshëm** | 1 | **1,991,780.93** | **2,018,063.42** | **2,018,063.42** | **2,012,141.81** | **99.71%** | **99.71%** |
| Paga dhe Meditje | | 1,445,892.93 | 1,472,175.42 | 1,472,175.42 | 1,472,175.42 | 100.00% | 100.00% |
| Mallrat dhe Shërbimet | | 241,660.00 | 241,660.00 | 241,660.00 | 235,747.12 | 97.55% | 97.55% |
| Shpenzimet Komunale | | 38,500.00 | 38,500.00 | 38,500.00 | 38,492.87 | 99.98% | 99.98% |
| Subvencione dhe Transferet | | 30,000.00 | 30,000.00 | 30,000.00 | 30,000.00 | 100.00% | 100.00% |
| Investimet Kapitale | | 235,728.00 | 235,728.00 | 235,728.00 | 235,726.40 | 100.00% | 100.00% |
| **Rezerva** | 2 | **-** | **-** | **-** | **-** | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Paga dhe Meditje | | - | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Mallrat dhe Shërbimet | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Shpenzimet Komunale | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Subvencione dhe Transferet | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Investimet Kapitale | | - | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Të hyrat vetanake** | 3 | **208,056.00** | **208,056.00** | **156,287.48** | **124,368.47** | **59.78%** | **79.58%** |
| Paga dhe Meditje | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Mallrat dhe Shërbimet | | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,000.00 | 4,994.53 | 99.89% | 99.89% |
| Shpenzimet Komunale | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Subvencione dhe Transferet | | 32,000.00 | 32,000.00 | 32,000.00 | 26,492.49 | 82.79% | 82.79% |
| Investimet Kapitale | | 171,056.00 | 171,056.00 | 119,287.48 | 92,881.45 | 54.30% | 77.86% |
| **Mjetet e bartura** | 4 | **-** | **147,963.74** | **147,963.74** | **82,727.54** | **55.91%** | **55.91%** |
| Paga dhe Meditje | | - | - | - | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Mallrat dhe Shërbimet | | - | 37,684.30 | 37,684.30 | 27,299.41 | 72.44% | 72.44% |
| Shpenzimet Komunale | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Subvencione dhe Transferet | | - | 400.00 | 400.00 | 400.00 | 100.00% | 100.00% |
| Investimet Kapitale | | - | 109,879.44 | 109,879.44 | 55,028.13 | 50.08% | 50.08% |
| **Grantet - Donacionet** | 5 | **-** | **2,469.85** | **2,469.85** | **-** | **0.00%** | **0.00%** |
| Paga dhe Meditje | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Mallrat dhe Shërbimet | | - | 17.50 | 17.50 | - | 0.00% | 0.00% |
| Shpenzimet Komunale | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Subvencione dhe Transferet | | - | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Investimet Kapitale | | - | 2,452.35 | 2,452.35 | - | 0.00% | 0.00% |

Gjatë vitit 2024 ka ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe aktual siç janë:

Transferi i donacioneve në shumë totale **2,469.85 €,** prej tyre **260.98 €** nga **UN-HABITAT** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **17.50 €** nga **KOSTT** në kategorinë Mallra dhe shërbime, **356.50€** nga SAVE THE CHILDREN janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **1,834.87€** nga DEMOS dhe SIDA janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale .

Transferi i të hyrave të pashpenzuara të vitit 2023 të bartura për shpenzim në vitin 2024 në shumë prej **147,963.74 €,** prej tyre: 37,684.30€ Ne kategorinë e Mallrave dhe Sherbimeve, 400.00€ Ne kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve dhe 109,879.44€ Ne kategorinë e investimeve kapitale.

Me vendim të qeverise nr. 03/239 të datës 24.12.2024 për harmonizime të brendshme është rritur kategoria e pagave **26,282.49€**

## TË HYRAT BUXHETORE 2024

Pasqyra aktuale Buxhetore 2024, si dhe pasqyrat finale buxhetore për vitet paraprake
Tabela - 2

| Burimi i mjeteve | Pranimet 2021 | Pranimet 2022 | Pranimet 2023 | Pranimet 2024 | Progresi 24/23 | Progresi 24/22 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **7=5/4** | **8=5/3** |
| Grandi Qeveritar | 1,390,864.63 | 1,522,995.28 | 1,990,003.76 | 2,018,063.42 | 101.41% | 132.51% |
| Të hyrat vetanake | 122,802.00 | 300,757.19 | 159,330.00 | 208,056.00 | 130.58% | 69.18% |
| Mjetet e Bartura | 31,830.15 | 91,915.99 | 195,144.42 | 147,963.74 | 75.82% | 160.98% |
| Donacionet | 2,469.85 | 2,469.85 | 2,469.85 | 2,469.85 | 100.00% | 100.00% |
| **Gjithsej** | **1,547,966.63** | **1,918,138.31** | **2,346,948.03** | **2,376,553.01** | **101.26%** | **123.90%** |

**GRAFIKONI I BURIMEVE FINANCIARE KOMUNALE ( % E PJESMARRJES )**



## TË HYRAT PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË

| | 2024 | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| | BKK | BKK | BKK | BKK |
| **Klasifikimi ekonomik** | € ' | € ' | € ' | € ' |
| Pagat dhe rrogat | 1,472,175.42 | 1,442,893.76 | 1,178,053.28 | 1,114,761.63 |
| Mallrat dhe shërbimet | 241,660.00 | 232,840.00 | 196,580.00 | 166,900.00 |
| Shërbimet komunale | 38,500.00 | 37,700.00 | 36,200.00 | 36,200.00 |
| Subvencionet dhe transferet | 30,000.00 | 20,000.00 | 20,000.00 | - |
| Shpenzimet kapitale | 235,728.00 | 256,570.00 | 92,162.00 | 73,003.00 |
| | **2,018,063.42** | **1,990,003.76** | **1,522,995.28** | **1,390,864.63** |

## TË HYRAT VETANAKE PERIODIKE 2024

Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: Tatimi në pronë, Te hyrat nga Shëndetësia, Te hyrat nga Regjistrimi i Automjeteve etj.... Të hyrat totale vetanake të grumbulluara Janar - Dhjetor 2024 kanë arritur në shumën prej **167,617.13 €** që përbën **80.50%** të planifikimit vjetor **(208,056,00€).**

## GRAFIKONI I TË HYRAVE VETANAKE PËRIODIKE 2021 - 2024



## Të hyrat vetanake kryesore periodike Janar – Dhjetor 2024

| Te Hyrat nga: | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | Realizimi 2023 | Planifikimi 2024 | Realizimi 2024 | Progresi me plan. | Progresi me /2023 | Progresi me /2022 | % në total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 = 5 / 4 | 7 = 5 / 3 | 8 = 5 / 2 | 7= 5/total |
| **Tatimi në pronë** | **89,598.59** | **96,238.45** | **113,499.64** | **127,505.00** | **98,143.77** | **77%** | **86%** | **102%** | **58.6%** |
| **Te hyrat nga Shendetsia** | **7,387.00** | **6,210.50** | **5,124.50** | **8,000.00** | **6,073.00** | **76%** | **119%** | **98%** | **3.6%** |
| **Te hyrat nga Administrata** | **6,288.00** | **6,654.50** | **6,052.50** | **8,000.00** | **6,082.00** | **76%** | **100%** | **91%** | **3.6%** |
| **Regjistrimi i Automjeteve** | **7,194.00** | **7,668.00** | **8,877.00** | **8,000.00** | **9,115.00** | **114%** | **103%** | **119%** | **5.4%** |
| **Te hyrat nga Gjobat ne trafik** | **-** | **-** | **7,050.00** | **-** | **11,966.00** | **#DIV/0!** | **170%** | **#DIV/0!** | **7.1%** |
| **Te hyrat nga lejet per ushtrim te veprimtarise** | **4,772.00** | **12,330.57** | **12,937.25** | **15,000.00** | **6,081.00** | **41%** | **47%** | **49%** | **3.6%** |
| **Te hyrat nga Urbanizmi** | **19,236.40** | **14,484.86** | **9,640.00** | **32,001.00** | **14,564.51** | **46%** | **151%** | **101%** | **8.7%** |
| **Të hyrat tjera** | **5,145.00** | **196,704.75** | **3,233.00** | **9,550.00** | **15,591.85** | **163%** | **482%** | **8%** | **9.3%** |
| **Totali** | **139,620.99** | **340,291.63** | **166,413.89** | **208,056.00** | **167,617.13** | **81%** | **101%** | **49%** | **100%** |




Ne kategorinë Të hyrat tjera bëjnë pjesë: (Të hyrat nga shërbimet publike-inspeksioni 3,467.00 €, te hyrat nga shitja e pasurisë 9,714.20 € dhe te hyrat nga ndërrimi i destinimit te tokës 2410.65 € ) gjithsejtë **15,591.85€**

Periudha Janar - Dhjetor 2024 karakterizohet me një realizim të të hyrave në total 167,617.13 € apo 80.50% në raport me planifikimin vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2023 kemi realizuar 100.72% apo 0.72% më shumë, shprehur në vlerë monetare diferenca është 1,203.24 € më shumë.

## SHPENZIMET BUXHETORE 2024

Planifikimi Buxhetor për 2024 duke përfshirë edhe donacionet është **2,376,553.01€,** gjatë kësaj periudhe janë alokuar mjete në vlerë **2,324,784.49€** ndërsa janë shpenzuar **2,219,237.82 €,** apo **95.46%** e buxhetit të alokuar.

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike.

| Nr | Përshkrimi | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | Alokimet TM4/24 | Progresi % | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8=6/5 | 9=6/7 |
| 1 | Pagat | 1,114,761.63 | 1,102,859.49 | 1,442,893.76 | 1,472,175.42 | 1,472,175.42 | 102.03% | 100.00% |
| 2 | Mallra e shërbime | 172,167.40 | 216,446.11 | 223,588.60 | 268,041.06 | 284,361.80 | 119.88% | 94.26% |
| 3 | Shpenzi. komunale | 29,878.29 | 32,053.35 | 31,883.38 | 38,492.87 | 38,500.00 | 120.73% | 99.98% |
| 4 | Subvencione | 21,550.00 | 58,885.82 | 51,664.18 | 56,892.49 | 62,400.00 | 110.12% | 91.17% |
| 5 | Shpenzi. Kapitale | 121,334.45 | 273,101.14 | 413,188.11 | 383,635.98 | 467,347.27 | 92.85% | 82.09% |
| | **Totali** | **1,459,691.77** | **1,683,345.91** | **2,163,218.03** | **2,219,237.82** | **2,324,784.49** | **102.59%** | **95.46%** |

**GRAFIKONI I SHPENZIMEVE DHE % E PJESMARRJES NË SHPENZIMET**



- Pagat dhe mëditjet të alokuara në vlerë 1,472,175.42€ janë shpenzuar 1,472,175.42€ apo 100.00% e mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak shpenzimi në këtë kategori është më i lartë për 2.03% për shkak të përvojës se punës dhe ndikimit të ndryshimeve pas hyrjes ne fuqi te ligjit te buxhetit për vitin 2024 rritja e vlerës se koeficientit te pagave. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 66.34% .

- Mallrat & shërbimet të alokuara në vlerë 284,361,80€ janë shpenzuar 268,041.06€ në përqindje 94.26% e mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara në këtë kategori janë në vlerë prej 16,320.74€, ose në përqindje 5.74%, nga të cilat 17.50 € janë mbetje nga Donacionet, 5.47€ janë mbetje nga te hyrat vetanake, 10,384.89€ janë mbetje nga te hyrat vetanake te bartura nga viti 2023 dhe 5,912.88€ nga granti i përgjithshëm të cilat kanë mbetur nga pagesat e ndryshme të bëra në kode dhe programe të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 19.88%. Pjesëmarrja e Mallrave & Shërbimeve në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 12.08%.

- Shpenzimet komunale - Komunalit të alokuara në vlerë 38,500.00€ janë shpenzuar 38,492.49€ ose në shkallën prej 99.98% të mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara ne këtë kategori janë në vlerë prej 7.13€ ose në përqindje 0.02% janë mbetje nga granti i përgjithshëm të cilat kanë mbetur nga pagesat e ndryshme të bëra në kode dhe programe të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 20.73%. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në shpenzimin total komunal është 1.73%.

- Subvencionet të alokuara në vlerë 62,400.00€ janë shpenzuar 56,892.49€ ose në shkallën prej 91.17% të mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara ne këtë kategori janë në vlerë prej 5,507.51€ ose në përqindje 8.83% janë mbetje nga të hyrat vetanake të cilat kanë mbetur te pashpenzuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 10.12%. Pjesëmarrja e shpenzimeve te subvencioneve në shpenzimin total komunal është 2.56%.

- Shpenzimet kapitale të alokuara në vlerë prej 467,347.27€ janë shpenzuar 383,635.98€ ose në shkallën prej 82.09% të mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara në këtë kategori janë në vlerë prej 83,711.29€ ose në përqindje 17.91% nga të cilat 26,406.03€ janë mbetje nga të hyrat vetanake, 2,452.35€ janë mbetje nga Donacionet dhe 54,851.31€ nga te hyrat e bartura nga viti 2023 dhe 1.60€ nga granti i përgjithshëm te cilat kanë mbetur nga pagesat e ndryshme të bëra ne kode dhe programe të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të ulëta për 7.15%. Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimin total komunal është 17.29%.

- Në total mjetet e alokuara për vitin 2024 në vlerë prej 2,324,784.49€ janë shpenzuar në vlerë prej 2,219,237.82€ ose në shkallën 95.46% të mjeteve të alokuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 shpenzimet janë më të larta për 2.59%.

**RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA , MALLA &SHERBIME SIPAS DREJTORIVE**

| Përshkrimi | Z.Kryetarit | Administrata | Zh. Ekono. | Sh. Publike | K. Komunal | B.Financa | Urbanizem |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Paga neto | 65,274.18 | 78,688.86 | 43,433.84 | 46,973.27 | 97,612.63 | 52,971.56 | 41,124.58 |
| Tatimi në paga | 5,876.53 | 3,798.78 | 2,629.61 | 3,517.39 | 7,062.62 | 3,527.95 | 2,973.67 |
| Kontributi pensional i punëtoreve | 3,824.77 | 4,638.76 | 2,536.30 | 2,837.51 | 6,422.50 | 3,082.14 | 1,878.98 |
| Sindikatat | - | | | | | | |
| Odat Profesionale | - | | | | | | |
| Përvoja e punes | 3,455.37 | 2,524.51 | 1,178.20 | 1,610.90 | 372.25 | 2,060.61 | 2,351.49 |
| Kontributi pensional i Punëdhënësit | 3,824.77 | 4,638.76 | 2,536.30 | 2,837.51 | 6,422.50 | 3,082.14 | 1,878.98 |
| Shtesa e veqant per te zgjedhurit | - | | | | 16,973.55 | | |
| Shtesa per nepunesin e sistemit shendetsor | - | | | | | | |
| Kujdestaria, puna jasht orarit te punes, puna g | 2,920.06 | 2,456.94 | 948.54 | 1,810.47 | | | |
| Shtesa Tranzitore | 3,593.51 | 664.20 | | | | | |
| Vendim gjykate | - | | | | | | |
| **TOTALI I PAGAVE & MED.** | **88,769.19** | **97,410.81** | **53,262.79** | **59,587.05** | **134,866.05** | **64,724.40** | **50,207.70** |
| Shpenzimet e udhtimit në Vendë | - | | | - | - | - | - |
| Shpenzimet e udhet. Jashtë Vendit | | 1,027.30 | 52.00 | 85.15 | | 478.53 | - |
| Shpenzimet e internetit | 5.00 | - | | - | - | 60.00 | - |
| Telefonia Mobile | 918.08 | 784.69 | 454.80 | 420.66 | | 555.36 | 341.68 |
| Sherbimet Postare | | 260.30 | | | | 1,167.50 | |
| Sherbimet e perfaqesimit avokatur | | 8,388.00 | | | | | |
| Sherbimet e ndryshme Shendetsore | - | | | | | | |
| Sherbimet keshilldhenese dhe profesionale | - | | | | | | 10,621.86 |
| Sherbimet e veqanta - konsulent dhe kontrakt | 1,819.46 | 15,421.70 | 1,650.00 | 2,350.00 | | 1,350.00 | 16,899.20 |
| Shërbime shtypje / printimit | 751.82 | 567.83 | 88.49 | 88.33 | | 295.88 | 758.38 |
| Shërbime kontraktuese tjera | | | | 5,180.09 | | | 2,810.00 |
| Shërbime teknike | - | 1,597.60 | - | - | - | - | - |
| Shpenzimet per anëtaresim | 912.60 | - | | - | - | | - |
| Mobile me pak se 1000€ | | | | | | | |
| Kompjuterë me pak se 1000€ | | | | | 730.00 | 2,550.00 | |
| Makina fotokopjuese | | | | | | | |
| Pajisje trafiku me pak se 1000€ | | | | 2,955.70 | | | |
| Pajisje tjera me pak se 1000€ | 280.00 | 429.80 | | 5,315.00 | | 142.00 | |
| Pajisjet specialistike mjeksore | | | | | | | |
| Furnizim i Zyrës | | 1,947.80 | | 685.10 | | | |
| Furnizim me ushqim dhe pije | 678.49 | 119.94 | 1,058.76 | 257.05 | | 138.59 | - |
| Furnizimet mjeksore | | 1,112.66 | | 413.50 | 1,495.00 | | |
| Furnizim e pastrimit | | | | | | | |
| Shpenzimet e veshmbathjes | | | | | | | |
| Akomodimi | | 440.00 | | | | | |
| Nafta për ngrohje | | 4,899.88 | | | | | |
| Dru dhe prodhimet e drurit per ngrohje | | | | | | | |
| Derivate për automjete, Gjenerator dhe makir | 2,319.30 | 1,734.25 | 973.58 | 3,000.28 | | 807.58 | 325.02 |
| Avans për para te imet (patty cash) | | - | | | | | |
| Regjistrimi dhe sig.automjeteve | 308.10 | 633.76 | 418.79 | 1,010.69 | - | | 418.79 |
| Sigur.I ndërtesave dhe të tjerave | | | | | | | |
| Mirëm. dhe riparim i automjeteve | | 940.00 | 370.00 | 734.40 | | | 497.50 |
| Mirmbajtja e monumenteve dhe komplekseve | - | | | 921.00 | | | |
| Mirëmbajtja e ndërtesave | | 499.70 | | | | | |
| Mirëmbajtja e rrugëve lokale | | | | 12,420.00 | | | |
| Mirmb.e teknologjisë informatike | | | | | | | |
| Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve | | 1,033.60 | | | | | |
| Mirmbajtja rutinore | | | | 983.00 | 974.00 | | 596.50 |
| Qiraja | | | | | | | 1,100.00 |
| Reklamat dhe konkurset | - | - | 2,000.00 | | | | |
| Botime dhe publikime | - | | | - | - | - | - |
| Kompensim i perfaqesimit brenda vendit | 1,192.50 | 600.00 | 1,338.00 | 810.50 | 696.00 | 598.00 | 86.00 |
| Vendim gjykate | | | | | | | |
| Pagesa Per Tarifa - Vendime gjyqsore permb | - | | | | | 34.22 | |
| Pagesa Vendime gjyqsore | | | | | | | - |
| **TOTALI M & SH** | **9,185.35** | **42,438.81** | **8,404.42** | **37,630.45** | **3,895.00** | **8,177.66** | **34,454.93** |

**RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA , MALLA &SHERBIME SIPAS DREJTORIVE**

| Përshkrimi | Ad. Arsim | Ars. fillor | A. i mesem | Ad. Shendet. | QKMF | Sh. Sociale | ZLK | Totali periodik 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Paga neto | 28,894.07 | 303,209.51 | 114,960.56 | 15,171.80 | 227,802.22 | 10,283.91 | 6,563.87 | **1,132,964.86** |
| Tatimi në paga | 2,013.45 | 19,228.21 | 7,532.66 | 1,195.93 | 17,063.34 | 536.21 | 424.41 | **77,380.76** |
| Kontributi pensional i punëtoreve | 1,679.37 | 17,808.28 | 6,840.01 | 916.52 | 13,810.07 | 594.13 | 381.51 | **67,250.85** |
| Sindikatat | | 992.83 | 410.83 | | | | | **1,403.66** |
| Odat Profesionale | | | | | 1,375.83 | | | **1,375.83** |
| Përvoja e punes | 1,001.09 | 13,398.59 | 6,139.41 | 1,045.19 | 11,110.55 | 466.92 | 259.99 | **46,975.07** |
| Kontributi pensional i Punëdhënësit | 1,679.37 | 17,808.28 | 6,840.01 | 916.52 | 13,810.07 | 594.13 | 381.51 | **67,250.85** |
| Shtesa e veqant per te zgjedhurit | | | | | | | | **16,973.55** |
| Shtesa per nepunesin e sistemit shendetsor | | | | | 3,999.00 | | | **3,999.00** |
| Kujdestaria, puna jasht orarit te punes, puna | - | 1,517.64 | 911.55 | | 1,041.73 | | | **11,606.93** |
| Shtesa Tranzitore | | | | | | | | **4,257.71** |
| Vendim gjykate | | 30,380.18 | 10,356.17 | | | | | **40,736.35** |
| **TOTALI I PAGAVE & MED.** | **35,267.35** | **404,343.52** | **153,991.20** | **19,245.96** | **290,012.81** | **12,475.30** | **8,011.29** | **1,472,175.42** |
| Shpenzimet e udhtimit në Vendë | - | | | | | | | **-** |
| Shpenzimet e udhet. Jashtë Vendit | | 1,866.30 | | | | 104.00 | | **3,613.28** |
| Shpenzimet e internetit | 12.99 | 25.98 | | | | | | **103.97** |
| Telefonia Mobile | 171.34 | 239.12 | 350.77 | 236.90 | 204.67 | | - | **4,678.07** |
| Sherbimet Postare | | | | | | | | **1,427.80** |
| Sherbimet e perfaqesimit avokatur | | | | | | | | **8,388.00** |
| Sherbimet e ndryshme Shendetsore | | | | | 105.00 | | | **105.00** |
| Sherbimet keshilldhenese dhe profesionale | | | | | | | | **10,621.86** |
| Sherbimet e veqanta - konsulent dhe kontrakt | 4,745.10 | 7,542.00 | | 2,000.00 | 42,730.10 | 1,300.00 | | **97,807.56** |
| Shërbime shtypje / printimit | 244.21 | 134.78 | 240.96 | | 2.86 | | | **3,173.54** |
| Shërbime kontraktuese tjera | | 11,392.50 | 4,242.00 | | | | - | **23,624.59** |
| Shërbime teknike | | | 649.95 | | | | | **2,247.55** |
| Shpenzimet per anëtaresim | | | | | | | | **912.60** |
| Mobile me pak se 1000€ | | | 1,404.00 | | | | | **1,404.00** |
| Kompjuterë me pak se 1000€ | | 3,894.00 | | | | | | **7,174.00** |
| Makina fotokopjuese | | | | | | | | **-** |
| Pajisje trafiku me pak se 1000€ | | | | | | | | **2,955.70** |
| Pajisje tjera me pak se 1000€ | 248.00 | 969.00 | 6,092.70 | 241.70 | | | | **13,718.20** |
| Pajisjet specialistike mjeksore | | | | | 960.00 | | | **960.00** |
| Furnizim i Zyrës | 2.00 | 688.00 | | 8.30 | 998.00 | | | **4,329.20** |
| Furnizim me ushqim dhe pije | 282.08 | 21.60 | 631.12 | 18.54 | 26.46 | | | **3,232.63** |
| Furnizimet mjeksore | | | | | 5,476.53 | | | **8,497.69** |
| Furnizim e pastrimit | | | | | | | | **-** |
| Shpenzimet e veshmbathjes | | | | | | | | **-** |
| Akomodimi | | | | | | | | **440.00** |
| Nafta për ngrohje | | | | | | | | **4,899.88** |
| Dru dhe prodhimet e drurit per ngrohje | | 8,550.00 | 2,002.50 | | | | | **10,552.50** |
| Derivate për automjete, Gjenerator dhe makin | 1,153.10 | 731.56 | 45.27 | 595.82 | 2,603.06 | 805.62 | - | **15,094.44** |
| Avans për para te imet (patty cash) | - | | - | - | | | | **-** |
| Regjistrimi dhe sig.automjeteve | | | | | 951.94 | | | **3,742.07** |
| Sigur.I ndërtesave dhe të tjerave | | | | | | | | **-** |
| Mirëm. dhe riparim i automjeteve | - | - | - | | 235.00 | | - | **2,776.90** |
| Mirmbajtja e monumenteve dhe kompleksev | - | | | | | | | **921.00** |
| Mirëmbajtja e ndërtesave | | | 187.50 | | | | | **687.20** |
| Mirëmbajtja e rrugëve lokale | | | | | | | | **12,420.00** |
| Mirmb.e teknologjisë informatike | | | | | | | | **-** |
| Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve | | 355.00 | | 82.00 | 1,496.00 | | | **2,966.60** |
| Mirmbajtja rutinore | | | | | | | | **2,553.50** |
| Qiraja | | | | | | | | **1,100.00** |
| Reklamat dhe konkurset | | | | | | | | **2,000.00** |
| Botime dhe publikime | | | | | | | | **-** |
| Kompensim i perfaqesimit brenda vendit | 883.01 | 2,274.50 | 135.00 | | | 144.00 | | **8,757.51** |
| Vendim gjykate | | | | | | | | **-** |
| Pagesa Per Tarifa - Vendime gjyqsore permb | - | | 120.00 | | | | | **154.22** |
| Pagesa Vendime gjyqsore | | | | | | | | **-** |
| **TOTALI M & SH** | **7,741.83** | **38,684.34** | **16,101.77** | **3,183.26** | **55,789.62** | **2,353.62** | **-** | **268,041.06** |

## SHPENZIMET ANALITIKE KOMUNALIVE, SUBVENCIONEVE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

| Përshkrimi | Z.Kryetarit | Administrata | Zh. Ekono. | Sh. Publike | K. Komunal | B.Financa | Urbanizem |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet e energjisë elektrike | | 6,505.20 | 284.78 | 8,580.12 | - | | |
| Shpenzimet e Ujët | | 149.07 | 106.06 | 486.81 | - | | |
| Shpenzimet e Mbeturinave | - | 486.00 | | 4,419.00 | - | - | - |
| Shpenzimet e Ngrohjes | | | | | | | |
| Shpenzimet Telefonike | 149.54 | 58.94 | 6.99 | 362.78 | - | 99.80 | |
| Pagesa Vendime gjyqsore | | - | - | - | - | - | - |
| **TOTALI KOMUNALËVE** | **149.54** | **7,199.21** | **397.83** | **13,848.71** | **-** | **99.80** | **-** |
| Subvencionet per etnitetet publike | 2,500.00 | | | | | | |
| Subvencionet per etnitetet jopublike | 53,168.04 | | | | | | |
| Vendim gjykate | 1,224.45 | | | | | | |
| **TOTALI SUBVENCIONEVE** | **56,892.49** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** |
| Ndërtesa te banuara | | | | | | | |
| Objekte Arsimore (Oborri I shkolles) | | | | | | | |
| Objektet kuturore | | | | | | | |
| Objektet shendetesore (Oborri QKMF) | | | | | | | |
| Auto Rrugëve | | | | | | | |
| Rrugët Lokale | | | 74,658.70 | 20,000.00 | | | |
| Trotuaret | | | | | | | |
| Kanalizimi | | | 19,799.88 | | | | 7,548.50 |
| Ujësjellësi | | | | | | | |
| Furniz.Rrymë | | | | 20,000.00 | | | |
| Paisje speciale mjeksore | | | | | | | |
| Pajisje tjera | | 9,480.00 | | 24,998.50 | | | |
| Mirmbajtja investive | | | | | | | |
| automjete transporti (autoambulanca) | | | | | | | |
| Deponite e mbeturinave | | | | 19,597.50 | | | |
| Pag.neni 39.2 LMFPP | | | | | | | |
| Pagesa Vendime gjyqsore | | 13,730.00 | 14,385.92 | 11,121.28 | | | 127,274.64 |
| **TOTALI I INVESTIMEVE** | **-** | **23,210.00** | **108,844.50** | **95,717.28** | **-** | **-** | **134,823.14** |
| **TOTALI I PËRGJITHSHËM** | **154,996.57** | **170,258.83** | **170,909.54** | **206,783.49** | **138,761.05** | **73,001.86** | **219,485.77** |

| Përshkrimi | Ad. Arsim | Ars. fillor | A. i mesem | Ad. Shendet. | QKMF | Sh. Sociale | ZLK | Totali periodik 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet e energjisë elektrike | | 2,526.54 | 1,537.98 | | 4,197.15 | 1,116.79 | | **24,748.56** |
| Shpenzimet e Ujët | | 833.25 | 624.72 | - | 435.72 | 308.31 | - | **2,943.94** |
| Shpenzimet e Mbeturinave | | 1,260.00 | 1,260.00 | - | 1,344.00 | 378.00 | - | **9,147.00** |
| Shpenzimet e Ngrohjes | | | | | | | | **-** |
| Shpenzimet Telefonike | | 379.85 | 175.88 | - | 223.06 | 196.53 | - | **1,653.37** |
| Pagesa Vendime gjyqsore | | | | | | | | **-** |
| **TOTALI KOMUNALËVE** | **-** | **4,999.64** | **3,598.58** | **-** | **6,199.93** | **1,999.63** | **-** | **38,492.87** |
| Subvencionet per etnitetet publike | | | | | | | | **2,500.00** |
| Subvencionet per etnitetet jopublike | | | | | | | | **53,168.04** |
| Vendim gjykate | | | | | | | | **1,224.45** |
| **TOTALI SUBVENCIONEVE** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **56,892.49** |
| Ndërtesa te banuara | | | | | | | | **-** |
| Objekte Arsimore (Oborri I shkolles) | | 7,268.17 | | | | | | **7,268.17** |
| Objektet kuturore | | | | | | | | **-** |
| Objektet shendetesore (Oborri QKMF) | | | | | 6,999.90 | | | **6,999.90** |
| Auto Rrugëve | | | | | | | | **-** |
| Rrugët Lokale | | | | | | | | **94,658.70** |
| Trotuaret | | | | | | | | **-** |
| Kanalizimi | | | | | | | | **27,348.38** |
| Ujësjellësi | | | | | | | | **-** |
| Furniz.Rrymë | | | | | | | | **20,000.00** |
| Paisje speciale mjeksore | | | | | | | | **-** |
| Pajisje tjera | | | | | | | | |
| Mirmbajtja investive | | | | | | | | **-** |
| automjete transporti (autoambulanca) | | | | | | | | **-** |
| Deponite e mbeturinave | | | | | | | | **19,597.50** |
| Pag.neni 39.2 LMFPP | | | | | | | | **-** |
| Pagesa Vendime gjyqsore | | 4,999.99 | | | 1,773.00 | | | **173,284.83** |
| **TOTALI I INVESTIMEVE** | **-** | **12,268.16** | **-** | **-** | **8,772.90** | **-** | **-** | **383,635.98** |
| **TOTALI I PËRGJITHSHËM** | **43,009.18** | **460,295.66** | **173,691.55** | **22,429.22** | **360,775.26** | **16,828.55** | **8,011.29** | **2,219,237.82** |

Shënime shpjeguese:
Në totalin e pagave të shpenzuara në vlerë prej **1,472,175.42€** janë nga granti i përgjithshëm, për pagesën e pagave të punëtorëve në listën e pagave, Mëditjet e komiteteve, shtesat e veçanta dhe një pjesë e vendimeve gjyqësore nga Kontrata kolektive e Arsimit .

Kategoria e Mallrave dhe shërbimeve të shpenzuara në vlerë prej **268,041.06€** nga granti i përgjithshëm janë 235,747.12€, nga te hyrat vetanake te vitit 2024 janë 4,994.53€, dhe nga te hyrat vetanake te bartura te vitit 2023 janë 27,299.41€.

Kategoria e Komunalive të shpenzuara në vlerë prej **38,492.87€,** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Kategoria e Subvencioneve të shpenzuara në vlerë prej **56,892.49€** nga granti i përgjithshëm janë 30,000.00€, nga te hyrat vetanake te vitit 2024 janë 26,492.49€ dhe nga te hyrat vetanake te bartura te vitit 2023 janë 400.00€.

Kategoria e Investimeve Kapitale të shpenzuara në vlerë prej **383,635.98€** nga granti i përgjithshëm janë 235,726.40€, nga te hyrat vetanake te vitit 2024 janë 92,881.45€ dhe nga te hyrat vetanake te bartura te vitit 2023 janë 55,028.13€.

Shpenzime sipas vendimeve Gjyqësore/Përmbarimore te ekzekutuara gjate vitit 2024 janë në vlerë totale prej **215,245.63€** të ekzekutuara 40,736.35€ nga Kategoria e Pagave, 1,224.45€ nga Kategoria e Subvencioneve dhe 173,284.83€ nga Kategoria e investimeve kapitale.

## Shpenzimet sipas Drejtorive dhe progresi me periudhën e njëjtë të viteve paraprake

| Shpenzimet Periodike sipas Drejtorive 2021-2024 | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Drejtoritë* | *2021* | *2022* | *2023* | *2024* | *Alokimet TM4 2024* | *Progr ./ alokim* | *Progr . me 2023* |
| 1 | Zyra e Kryetarit | 102,970.48 | 140,858.65 | 140,322.79 | 154,996.57 | 160,619.19 | 96.5% | 110.5% |
| 2 | Kuvendi Komunal | 55,772.14 | 57,629.55 | 133,297.91 | 138,761.05 | 138,866.05 | 99.9% | 104.1% |
| 3 | Administratë | 125,643.42 | 139,701.51 | 168,870.36 | 170,258.83 | 171,120.81 | 99.5% | 100.8% |
| 4 | Buxhet dhe Financa | 64,453.08 | 64,807.98 | 60,774.64 | 73,001.86 | 73,024.40 | 100.0% | 120.1% |
| 5 | Zhvillimi Ekonomik | 75,493.99 | 140,926.39 | 136,310.63 | 170,909.54 | 250,093.63 | 68.3% | 125.4% |
| 6 | Sh.publike | 158,306.17 | 208,683.08 | 152,355.32 | 206,783.49 | 207,382.05 | 99.7% | 135.7% |
| 7 | Planifikimi urban | 108,711.39 | 129,110.19 | 335,720.38 | 219,485.77 | 229,878.64 | 95.5% | 65.4% |
| 8 | ZKK | 2,873.15 | 6,851.86 | 2,862.22 | 8,011.29 | 8,011.29 | 100.0% | 279.9% |
| 9 | Shendetsia | 287,173.45 | 306,699.33 | 358,558.36 | 400,033.03 | 403,129.87 | 99.2% | 111.6% |
| 12 | Arsimi | 478,294.50 | 488,077.37 | 674,145.42 | 676,996.39 | 682,658.56 | 99.2% | 100.4% |
| ***Totali Buxhetor*** | | **1,459,691.77** | **1,683,345.91** | **2,163,218.03** | **2,219,237.82** | **2,324,784.49** | **95.5%** | 102.6% |

**GRAFIKONI I SHPENZIMEVE TE DREJTORIVE SI DHE PJESMARRJA NE SHPENZIMIN TOTAL**




Në kuadër të Shëndetësisë janë të përfshira: Drejtoria e Shëndetësisë (Administrata), QKMF dhe Shërbimet Sociale.
Në kuadër të Arsimit janë të përfshira: Drejtoria e Arsimit (Administrata), Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm.

## ❖ Progresi i shpenzimeve kapitale sipas projekteve për vitin 2024

| Emri i projektit | Kodi i projektit në Thesar | Buxheti 2024 | Alokimet TM4/ 2024 | Shpenzimet aktuale I - XII / 2024 | Struktura në % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Bashkefinancim I projekteve | 46030 | 182,451.81 | 156,839.99 | 83,349.50 | **53.14** |
| Rehabilitim I rrugeve Lokale ne qytetin e Junikut | 53896 | 20,000.00 | 20,000.00 | 20,000.00 | **100.00** |
| Kanalizimi I ujrave te zeza lokacioni Moronice Lagja Krasniq | 53946 | 9,326.00 | 9,326.00 | 9,326.00 | **100.00** |
| Rregullimi I infrastruktures se oborrit te SHFMU E. Hoxha | 54996 | 10,000.00 | 10,000.00 | 7,268.17 | **72.68** |
| Ndertimi I rrethojes dhe Rikonstruimi I oborrit te stacionit te autobuseve | 55002 | 7,000.00 | 7,000.00 | 5,000.00 | **71.43** |
| Ndertimi I Kanaleve te ujitjes Lagja Pepsh, Krraku, Arifaj | 55004 | 20,000.00 | 20,000.00 | 20,000.00 | **100.00** |
| Vendosja e Kamerave te Sigurise ne Komunen e Junikut | 55006 | 25,000.00 | 25,000.00 | 24,998.50 | **99.99** |
| Ndertimi I rrjetit te ndriqimit publik ne rruget lokale junik | 55010 | 20,000.00 | 20,000.00 | 20,000.00 | **100.00** |
| Rregullimi I infrastruktures per deponine e mbeturinave inerte | 55012 | 20,000.00 | 19,643.25 | 19,608.28 | **99.82** |
| Zerimi I Salles se Kuvendit Komunal | 55013 | 13,000.00 | 13,000.00 | 13,000.00 | **100.00** |
| Rekonstruimi I oborrit ne QKMF | 55014 | 10,000.00 | 10,000.00 | 6,999.90 | **70.00** |
| Ndertimi I Sheshit te qendres se Komunes se Junikut | 55028 | 150,000.00 | 124,200.05 | 124,200.00 | **100.00** |
| Rregullimi I hapsirave sportive, rekreative dhe te ambientit | 51003 | 4,999.99 | 4,999.99 | 4,999.99 | **100.00** |
| Blerja e Automjetit per nevoja te Komunes | 53227 | 210.00 | 210.00 | 210.00 | **100.00** |
| Furnizim me gjenrator per Objektin e Komunes | 53232 | 10,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 | **100.00** |
| Rekonstruimi I rruges Gaxherr Bajraktar | 53439 | 54.00 | 54.00 | 54.00 | **100.00** |
| Ndertimi I rrethojes dhe rregullimi I oborrit ne QPS dhe QKMF | 53470 | 773.00 | 773.00 | 773.00 | **100.00** |
| Ndriqimi I hapsirave publike pergjate shtratit te lumit Erenik | 53537 | 10,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 | **100.00** |
| Hapja dhe rregullimi I rruges ne fshatin Gjocaj | 53575 | 1,110.50 | 1,110.50 | 1,110.50 | **100.00** |
| Hapja e rrugeve fushore lokacioni Trojet, Gjocaj etj | 53869 | 355.00 | 355.00 | 355.00 | **100.00** |
| Ndertimi I kanalizimit sekondar te ujrave te zeza lokacioni Bajraktar | 53877 | 1,060.89 | 1,060.89 | 1,060.89 | **100.00** |
| Ndertimi I kanaleve te ujitjes topilla Gaxherr | 53882 | 140.00 | 140.00 | 140.00 | **100.00** |
| Ndertimi I mureve mbrojtese lokacioni Tofaj dhe Pepsh | 53947 | 182.25 | 182.25 | 182.25 | **100.00** |
| Furnizim me pajisje per analiza Laboratorike ne QKMF | 53948 | 1,000.00 | 1,000.00 | 1,000.00 | **100.00** |
| Permiresim I qas.kujde.zhvill. Gjate femijerise | 94618 | 356.50 | 356.50 | - | **-** |
| Participim I projekteve | 88351 | 260.98 | 260.98 | - | **-** |
| Ngritja e performances | 92052 | 1,834.87 | 1,834.87 | - | **-** |
| **Totali** | | **519,115.79** | **467,347.27** | **383,635.98** | **82.09** |

**Në Projektin bashkëfinancim i projekteve janë të përfshira: Ndërtimi i urës që lidhë Komunën e Junikut me ekofshatrat Gjocaj dhe Jasiq – punët shtese në vlerë prej 6,207.00€ ne bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Rekonsrtruimi dhe zgjerimi i rrugës Junik – Rastovice ne vlere prej 50,000.00€ ne bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës. Asfaltimi i rrugëve lokale në lagjet Berish, Qestaj, Gacafer, Gaxherr dhe Qendër " – faza e parë" ne vlere prej 18,451.70€ Ne bashkëfinancim me MAPL*

*Pagesa për vendime Gjyqësore Përmbarimore janë 173,284.83€ nga Projektet : Bashkëfinancim i projekteve 8,690.80€ , Ndërtimi i Sheshit te qendrës se Komunës se Junikut 124,200.00€, Zërimi i Sallës se kuvendit komunal 3,520.00€, Ndërtimi i rrethojës dhe rikonstruimi i oborrit te stacionit te autobusëve 5,000.00€, Kanalizimi i ujrave te zeza lokacioni moronice dhe lagja krasniq 1,777.50€, Rregullimi i infrastrukturës për deponine e mbeturinave inerte 10.78€, Ndërtimi i kanaleve te ujitjes Lagja Pepsh Krraku, Arifaj 200.12€, Rregullimi i hapësirave sportive, rekreative dhe te ambientit 4,999.99€, Blerja e Automjetit për nevoja te Komunës 210.00€, Furnizim me gjenerator për Objektin e Komunës 10,000.00€, Rekonstruimi i rrugës Gaxherr Bajraktar 54.00€, Ndërtimi I rrethojës dhe rregullimi I oborrit ne QPS dhe QKMF 773.00€, Ndriçimi I hapësirave publike përgjatë shtratit te lumit Erenik 10,000.00€, Hapja dhe rregullimi I rrugës ne fshatin Gjocaj 1,110.50€, Hapja e rrugëve fushore lokacioni Trojet, Gjocaj etj 355.00€, Ndërtimi I kanalizimit sekondar te ujërave te zeza lokacioni Bajraktar, 7 shtatori , Qendër 1,060.89€, Ndërtimi I kanaleve te ujitjes topilla Gaxherr 140.00€, Ndërtimi I mureve mbrojtëse lokacioni Tofaj dhe Pepsh 182.25€, Furnizim me pajisje për analiza Laboratorike ne QKMF 1,000.00€.*

**Mjetet e alokuara për Investime kapitale janë 467,347.27€ nga këto burime:**

- Grandi 235,728.00€ + Te hyrat vetanake 119,287.48€ + Te hyrat e bartura 109,879.44€ dhe 2,452.35€ nga donacionet.

Realizimi i buxhetit për investime kapitale në total është 383,635.98€ **,** prej tyre (235,726.40€ nga Grandi + 92,881.45€ nga të hyrat vetanake + 55,028.13€ nga të hyrat e bartura dhe 0.00€ nga Donacionet).

Progresi i realizimit te investimeve Kapitale karshi mjeteve të alokuara për vitin 2024 është **82.09% .**

**PASQYRA E OBLIGIMEVE TË PA PAGUARA JANAR– DHJETOR 2024**

| Programet Buxhetore | M&SH | Komunali | Subvencione | Kapitale | Gjithsej | Borgji momental | Pagesa deri me 00/00/24 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1,155.11 | 5,820.96 | - | - | 6,976.07 | | |
| | | | | | - | | - |
| | | | | | - | | - |
| | | | | | - | | - |
| | | | | | - | | - |
| **GJITHSEJ** | **1,155.11** | **5,820.96** | **-** | **-** | **6,976.07** | **-** | **-** |

**Të arkëtueshmet**

| | | **2024** |
|---|---|---|
| **Kodi ekonomik** | **Përshkrimi** | **€ '000** |
| 40110 | Tatim ne prone | 236,032.34 |
| 50019 | Licenca (Ushtrimi i veprimtarisë) | 70,916.18 |
| 50408 | Qiraja nga objektet publike | 2,200.00 |
| **Gjithsej** | | **309,148.52** |

## ❖ REKAPITULLIMI I INFORMATËS FINANCIARE

Kjo informatë periodike Janar – Dhjetor / 2024 ka për qëllim informimin detal dhe objektiv për të gjithë treguesit financiar, qofshin pozitive apo negative.
Qëllimi kryesor i këtij raporti është që rezultatet pozitive të menaxhimit të këtij buxheti ti forcojmë dhe ti rrisim më tutje, ndërsa treguesit negativë ti eliminojmë gjatë periudhave në vijim. E tërë kjo me qellim që të jemi sa më të suksesshëm në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për qëllimet e përcaktuara me planet dinamike të veprimit sipas ligjit mbi Buxhetin.

## ❖ PLANIFIKIMI BUXHETOR JANAR - DHJETOR 2024

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vlerë **2,199,836.93€** ka pasur ndryshime – rritje në periudhën Janar – Shtator 2024 për: **2,469.85€,** nga mjetet e pranuara nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2023. Bartja e te hyrave te pashpenzuara të vitit 2023 te bartura për shpenzim në vitin 20243 në shumë prej **147,963.74€,** Me vendim të qeverise nr. 03/239 të datës

24.12.2024 për harmonizime te brendshme është rritur kategoria e pagave **26,282.49€** Do të thotë buxheti total për vitin 2024 ka vlerën: **2,376,553.01€.**

## ❖ SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE JANAR - DHJETOR 2024

- **Shpenzimet nga Grandi qeveritar:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë ***2,018,063.42€***, janë shpenzuar ***2,012,141.81€*** që do të thotë **99.71%** të mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga të hyrat vetanake:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë ***156,287.48€***, janë shpenzuar ***124,368.47 €*** që do të thotë **79,58%** te mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga Mjetet e bartura të viti paraprak:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë ***147,963.74€***, janë shpenzuar ***82,727.54 €*** që do të thotë **55,91%** te mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga Donacionet dhe Participimet:** Nga mjetet e pranuara në vlerë ***2.469.85€*** janë shpenzuar ***0.00€*** ose **0.00%** të mjeteve të alokuara – pranuara.

- **Ne përgjithësi në vitin 2024 vlen të përmendet efikasitet i lartë në menaxhimin e buxhetit (pagesa) 95.46% e mjeteve të alokuara buxhetore, krahasuar me viti2 2023 kemi shpenzime më të larta prej 2.59%.**

## ❖ TË HYRAT BUXHETORE PERIODIKE JANAR - DHJETOR 2024

- **Të Hyrat Vetanake: Komuna ka realizuar të hyra vetanake në periudhën Janar - Dhjetor 2024, me donacione 306,721.07€ ose 13.19% të alokimeve prej 2,324,784.49€.**

- **Pengesat që kanë ndikuar në rezultate edhe më të mëdha janë:**

1. Grandi Qeveritar jo i mjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve te parapara nga Komuna dhe kufizimet ne planifikimin e shpenzimeve operative.
2. Obligimet nga Kontrata kolektive e arsimit

Duke pasur parasysh indikatorët e lartë cekur Komuna e Junikut, në Periudhën Janar –Shtator 2024 ka arritur rezultate të mira të cilat u bënë të ditura më lartë.

| ZKF | Drejtori Buxhet e Financa | Kryetari i Komunës |
|---|---|---|
| Arten Hamza | Vjollca Qestaj | Ruzhdi Shehu |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-155/675
Nr. i faq. 67
Data 24/01/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | **24.01.2025** |
| PËR/ZA/TO: | **z.Shpejtim Gacaferi** - Kryesues i Kuvendit Komunal |
| CC: | **z.Ruzhdi Shehu** - Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | **znj.Leonora Shehu** - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme |
| TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT: | Kërkesë |

I nderuar,

Duke u bazuar në rekomandimin e dhënë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – Departamenti Ligjor, për plotësimin e Rregullores për Transparencë dhe Planit të Veprimit të Rregullores, pasi ka ndodhë një gabim teknik dhe nuk është përcjellë Rregullorja si e plotë, kërkojm nga ju të vendosni në rend dite miratimin e Rregullores dhe Planit me pjesën e plotësuar.

Të bashkëngjitur gjeni të plotë Rregulloren dhe Planin e Veprimit për Transparencë.

Me respekt!

JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

KOMUNA E JUNIKUT

# Plani i veprimit për transparencë

Periudha 2024-2028

2024

## Deklarata e transparencës

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një pikëpamje gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me transparencën, gjithëpërfshirjen, kulturën organizative dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregullative.

Plani i Veprimit për transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse. Përmes Planit, do të promovohet koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, në mënyrë që politikbërja të bazohet në argumente, fakte dhe të dhëna reale. Plani është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjinë për Vetëqeverisje lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit, synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Për këtë arsye, zotohemi që Komuna e Junikut me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të qytetarëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të japin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Me plan të transparencës, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet, objektivat, metodat dhe mjetet efektive për rritjen e llogaridhënies, inkurajimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e qeverisjes, si dhe të ndikojmë tek punonjësit për të promovuar sjellje të mirë dhe të përgjegjshme.

Në vlerësojmë se planifikimi i bazuar në informacion është metoda më e mirë e ndërtimit të qëndrueshëm të vizionit zhvillimor. Në funksion të kësaj, shërbimet cilësore komunale dhe administrimi i kërkesave të qytetarëve varet drejtpërdrejtë nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemet e aplikuara të informacionit, teknikat e konsultimit dhe veprime të tjera përcjellëse të organeve të administratës.

Prandaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e ndërlidhura me informim, por të bëjmë përpjekje për të siguruar praninë e vazhdueshme të qytetarëve dhe grupeve të interesit, me theks të veçantë organizatave të shoqërisë civile, duke përvijuar konceptin qytetarisë aktive dhe ndërtimit të qeverisjes së opinionit publik.

Besojmë që ky plan veprimit për transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publike, gatishmërisë dhe përkushtimit më të madh, si dhe përpjekjeve për të fuqizuar e përmirësuar sistemin e menaxhimit brenda komunal.

Kryetari i Komunës

z.Ruzhdi Shehu

## Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarrje me bazë të gjerë. Fryma e institucioneve komunale duhet të adoptoj modelet më të avancuara të qeverisjes transparente brenda kornizës ligjore në fuqi .

Transparenca komunale është njëra nga segmentet e qeverisjes e cila monitorohet në vazhdimësi nga qeveria qendrore, por edhe nga akterë të tjerë ndërkombëtar, Komisioni Evropian, organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare. Marrë parasysh nivelin e përgjegjësive dhe shkallën e decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë, Kushtetuta dhe legjislacioni kanë paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje në faza të caktuara të procesit te avancimit të transparencës dhe zhvillimit të politikave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale.

Komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara t'i krijojnë mekanizmat e përshtatshëm të informimit publik. Tani, struktura e ueb-faqeve zyrtare të komunave është unike. Përmes tyre është krijuar mundësia për qasje në të gjitha dokumentet me rëndësi publike. Përveç karakterit informues, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe linja me ndërfaqe të tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë, mundëson që qytetarët të parashtrojnë online të gjitha kërkesat e tyre ndaj drejtorive përkatëse në komunë.

Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirë organizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Plani i Veprimit për Transparencë synon t'i grupoj përgjegjësitë kryesore të komunave bazuar në rregullat juridike për administratë të hapur, për të shërbyer si dokument kornizë në një periudhë afatgjatë.

# PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Plani i Veprimit për Transparencë Komunale ka për qëllim t'i ofrojnë publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) NR. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, në nenin 42 përcakton obligimin e komunave për të hartuar planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkohet të përfshijë veprime që promovojnë: Mbledhjet e Kuvendit të Komunës; Komiteteve; Takimet publike; Takimet konsultative për projektakte; Transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të komunë; Qasje të shpejtë në shërbime; Procedurat transparente të Prokurimit; Procedurat të punësimit; Përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare; Përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje etj.

**Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:**

- Ndërlidhjen e planifikimit me sistemet e informacionit në mënyrë që supozimet e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legjitimohen;
- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në vendimmarrje dhe politikbërje;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithshme të qytetarëve.

**Plani i veprimit për transparencë në mënyrë specifike kontribuon që:**

- Komuna të identifikoj me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetareve apo grupeve të interesit;
- Të identifikoj metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre;
- T'i evitoj praktikat e zhvillimit të dokumenteve pa informacion të qartë dhe me kosto të papërballueshme;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave;
- Mbajtjen e një sistemi koherent me të gjitha palët e interesit për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;

- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës. Plani do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e kryetarit, njoftimet për aktivitetet e kuvendit komunal, takimet publike, transparencës buxhetore, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit, qasjen në dokumentet publike, etj.

## Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive. Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimesh të bazuara në: informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

## Korniza ligjore për transparencë

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës janë miratuar një numër i madh i ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e transparencës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është aprovuar në vitin 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në grupin e ligjeve me karakter vital për shtetin. Përmbajtja e këtij ligji reflekton parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke paraparë mekanizma të veçantë të informimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të drejtave të komuniteteve joshumicë. Me këtë ligj është përcaktuar që kuvendi i komunës të miratojë rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunë. Përveç kësaj, me anë të një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore janë definuar edhe procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, janë përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale. Në përgjithësi, kuadri juridik normon obligime për organet e administratës shtetërore në fushën e transparencës, ndërsa në veçanti për organet e pushtetit, përmes akteve si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
- Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar
- Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2021 për Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve Të Qytetarëve në Komunë;
- Udhëzim Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna;

Aktet komunale:

- Statuti i komunës;
- Rregullore komunale për transparencë;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

## Qasja strategjike për fuqizimin e transparencës

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndër strategjitë kryesore në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Rregullim më të Mirë 2017-2021;
- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021;
- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA)
- Strategjitë e tjera sektoriale.

Dokument me rëndësi të veçantë për transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategjia parasheh *forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive.* Bazuar në problemet e identifikuara, në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rinore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës;
- Politikat lokale për krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, sportive dhe kulturore.[1]

Strategjia parasheh po ashtu masa konkrete në krijimin e platformave që fuqizojnë transparencën, e në veçanti përmes qeverisjes elektronike. Qeveria elektronike sigurisht që lehtëson komunikimin në mes të grupeve të interesit me autoritetet publike, derisa ajo forcon administratën përmes: kursimit të kohës në ofrimin e shërbimeve, uljes së kostos operative, rritjes së efikasitetit, ruajtjes

[1] Qeveria e Republikës së Kosovës: *"Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026"*, Prishtinë, 2016, fq. 32.

së memories institucionale dhe rritjes së llogaridhënies. Edhe strategji të tjera në nivel vendi ofrojnë qasje shumëdimensionale për ndërhyrje në politikat e transparencës.

Andaj, masat e tilla të ndërhyrjes janë të rëndësishme, për faktin se përmirësojnë komunikimin me qytetarë, krijojnë hapësirë për politikbërje të qëndrueshme, zbatim efikas të tyre, si dhe plotësojnë obligimet e Kosovës në raport me kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian.

## Mekanizmat ligjorë për pjesëmarrje dhe zbatim të parimit të transparencës

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e paanësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin se përmes organeve të pushtetit lokal. Komunat janë adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mblidhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunat ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarët, bizneset, grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimet e tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politikbërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projektakte dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike.
- Komitetet konsultative;
- Iniciativat qytetare, peticionet dhe referendumet lokale;

Udhëzimi Adminstrativ për Administratë të Hapur në Komunë ka përcaktuar buxhetimin me pjesëmarrje si një instrument të cilin komunat mund të shfrytëzojnë për të rritur pjësemarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, dhe për të avansuar transparencën e procesit të buxhetimit.

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikat e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

## Objektivat e Planit të Veprimit për transparencë

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është *"të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse"*.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgjohen dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i hartimit të politikave është baza e informacionit.
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

### Fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale

Zhvillimi i Model – Planit të veprimit për transparencë përbëhet prej disa faza si në vijim:

1) ***Faza Paraprake*** – Kryetari i komunës themelon grupin e punues. Përbërja e grupit punues duhet të jetë shumësektoriale dhe të udhëhiqet nga Zyra për Komunikim Publik në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.
2) ***Faza e vlerësimit të prioriteteve*** – gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionet e mbledhura (legjislacionin dhe aktet nënligjore të

zbatueshme në punën e administratës së komunës; dokumentet strategjike të komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate, duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.

3) ***Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave*** – kjo fazë përfshin kategorizimin e prioriteteve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.
4) ***Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë*** - përfshin monitorimin, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të veprimit për transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

## Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioriteteve, duke mundësuar që komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit: 1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës; Llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve; Fushëveprimit të akteve juridike të planifikuara për hartim; Ndikimit të tyre ekonomik dhe social; Peshës financiare të politikës së propozuar; Periudhës kohore të veprimit; Shtrirjes gjeografike; etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve, grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit si pjesë përbërëse të planit të veprimit, që janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

## Monitorimit i zbatimit të Planit të transparencës

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politikbërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të planit të veprimit për transparencë, krijohet mekanizmi për monitorimin dhe raportimin për këtij plani, si në vijim:

*Grupi punues* - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh sigurues i zbatimit të planit dhe garanton që në baza periodike Plani Vjetor i Punës së Komunës të ndërlidhet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Monitoron zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e planit të veprimit për transparencë;

Plani i Veprimit për Transparencë Komunale

| Objektivat | Aktivitetet | Treguesit e matjes | Afati kohor | Njësia/person i përgjegjës | Mënyra e njoftimit / zbatimit | Dokumentet referuese | Kolonë raportimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Transparenca e kuvendeve të komunave | | | | | | | |
| Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve | Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të nevojshme, hapësirës për pjesëmarrjen publikut dhe përfaqësuesit e mediave të shkruara/elektronike në takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve | 1) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të kuvendit në ueb faqe zyrtare të komunës, kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të komunës, apo format e tjera të informimit.<br><br>2) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të komiteteve në ueb faqe zyrtare të komunës, kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të komunës, apo format e tjera të informimit. | 1) Njoftimi shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta Kuvendit;<br><br>2) Njoftimi 3 ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme ;<br><br>3) Thirrja brenda ditës për mbledhje urgjente | Kryesuesi i kuvendit të Komunës;<br><br>Sekretaria e Kuvendit;<br><br>Zyra për Komunikim Publik. | Përmes ueb-faqes zyrtare; Shpalljeve publike; Rrjete sociale; Formave të tjera të informimit. | - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;<br><br>- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna<br><br>- Statuti i Komunës;<br><br>- Rregullorja komunale për transparencë | |
| | Transmetimi në kohë reale i mbledhjeve të kuvendit të komunës | Numri i mbledhjeve të kuvendit të transmetuara drejtpërdrejtë. | Në vazhdimësi | Sekretaria e kuvendit;<br><br>Zyrtara e IT-së;<br><br>Zyra e informimit. | Përmes ueb-faqes zyrtare;<br><br>E-komunat;<br><br>Youtube;<br><br>Mediave lokale; | - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;<br><br>- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna; | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | -Statuti i Komunës;<br><br>-Rregullorja komunale për transparencë. | |
| | Publikimi i akteve të kuvendit të komunës pas plotësimit të kushteve ligjore (Statutit, Rregulloreve, Vendimeve) | 1) Numri i akteve të aprovuara;<br><br>2) Numri i akteve të publikuara në gjuhët zyrtare | Pas afatit 15 ditor të vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për qeverisje lokale | Kryesuesi i kuvendit;<br><br>Zyra për informim | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Gazeta Zyrtare e Kosovës | Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;<br><br>Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës | Plani i publikuar në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës | Fillimi i muajit Janar | Zyra për informim | Ueb-faqja e komunës; | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Publikimi i Strategjive dhe dokumentet e tjera të politikave të kuvendit të komunës; | 1. Numri i strategjive dhe dokumenteve të politikave i aprovuar;<br><br>2. Numri i Strategjieve dhe dokumenteve të politikave, i publikuar | Pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim | Zyra e komunikimit me njësitë përgjegjëse për hartimin e dokumenteve | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Platforma të tjera. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i Planeve hapësinore komunale: Planin Zhvillimor të Komunës, Hartat Zonale, Planet Rregulluese të Hollësishme; | 1. Numri i Planeve të aprovuara;<br><br>2. Numri i Planeve të publikuara | Pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim | Zyra e komunikimit me njësitë përgjegjëse për hartimin e dokumenteve | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Platforma të tjera. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Ofrimi i qasjes së drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike | Informatat dhe dokumentet zyrtare të publikuara në ueb-faqen e komunës | Në vazhdimësi | Zyra për informim;<br><br>Njësitë organizative;<br><br>Sekretaria e Kuvendit. | Ueb-faqja e komunës; | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i raporteve të punës së kuvendit të komunës | Raporti vjetor i publikuar në gjuhët zyrtare | Deri më 31 janar për vitin paraprak | Sekretaria e Kuvendit;<br><br>Zyra për informim. | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Platforma të tjera sociale. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i dokumenteve të prodhuara nga Kuvendi i Komunës përfshirë procesverbalet e takimeve të kuvendit të komunës, | 1. Numri i dokumenteve të hartuara;<br><br>2. Numri i dokumenteve të publikuara brenda afateve ligjore. | Pas aprovimit të dokumenteve në mbledhjet e radhës | Sekretaria e Kuvendit;<br><br>Zyra për informim. | Ueb-faqja e komunës. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | komiteteve obligative, komiteteve të tjera konsultative, si dhe materialet e tjera publike të prodhuara nga Kuvendi i Komunës. | | | | | | |
| | Publikimi i Video-incizimeve të mbledhjeve të kuvendeve të komunës dhe materialet tjera të teleprezencës me linqet përcjellëse | 1. Numri i video-materialeve të incizuara;<br><br>2. Numri i video-materialeve, i publikuar | Pas mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit | Sekretaria e Kuvendit;<br><br>Zyra për informim. | Ueb-faqja e komunës; | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i profileve të anëtarëve të kuvendeve të komunave | Biografitë e anëtarëve të kuvendit dhe të dhënat kontaktuese të publikuara; | Me rastin e marrjes së mandatit; | Sekretaria e Kuvendit;<br><br>Zyra për informim. | Ueb-faqja e komunës; | Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike | |
| | Publikimi i të dhënave për përbërjen e komiteteve të kuvendit dhe funksioneve të tyre | 1) Të dhënat e përfaqësuesve në komitete të publikuara;<br><br>2) Vendimet për themelimin e komiteteve të publikuara;<br><br>3) Përgjegjësitë e komiteteve të përshkruara në ueb-faqe. | Sipas kohës së themelimit dhe funksionalizimit; | Sekretaria e Kuvendit;<br><br>Zyra për informim. | Ueb-faqja e komunës | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna<br><br>Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| **Transparenca e Kryetarit të Komunës / Përfshirja e qytetarëve/ Qasja në dokumentet publike / Informimi publik** | | | | | | | |
| **Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së kryetarit/ekzekutivit** | Publikimi i profileve të kryetarit dhe drejtorëve të emëruar të drejtorive | Biografitë dhe kontaktet e publikuara | Me rastin e marrjes së mandatit; | Zyra për informim; | Ueb-faqja e komunës; | Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike | |
| | Publikimi i informatave kryesore dhe të shërbimeve për secilën njësi organizative të komunës | Të dhënat për shërbime dhe kontaktet e publikuara | Në vazhdimësi | Zyra për informim; | Ueb-faqja e komunës; | Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike | |
| | Publikimi i akteve të kryetarit të komunës (vendimeve dhe urdhëresave) | 1. Numri i akteve të aprovuara;<br><br>2. Numri i akteve të publikuara | Publikimi pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim | Zyra për informim;<br><br>Zyra e Kryetarit | Ueb-faqja e komunës<br><br>Komuna mund të shfrytëzoj edhe platforma të tjera për të publikuar aktet dhe dokumentet e nxjerra veçanërisht ato me karakter informues dhe vetëdijusese. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Publikimi i akteve të drejtorive të komunës | 1. Numri i akteve të aprovuara;<br><br>2. Numri i akteve të publikuara. | Publikim pas plotësimit të kushteve ligjore | Zyra për informim;<br><br>Drejtoria përkatëse | Ueb-faqja e komunës<br><br>Komuna mund të shfrytëzoj edhe platforma të tjera për të publikuar aktet dhe dokumentet e nxjerra veçanërisht ato me karakter informues dhe vetëdijusese. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i Planit vjetor të punës së Kryetarit dhe drejtorive; | Plani i publikuar | Pas aprovimit | Zyra për informim;<br><br>Zyra e kryetarit<br><br>Njësitë përkatëse | Ueb-faqja e komunës | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i Strategjive dhe dokumentet e politikave të hartuara dhe aprovuara nga ekzekutivi; | 1. Numri i strategjive, dokumenteve të aprovuara<br><br>2. Numri i strategjive, dokumenteve të publikuara | Pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim | Zyra për informim;<br><br>Zyra e kryetarit | Ueb-faqja e komunës | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Diskutimi i raportit te kryetarit në kuvendin e komunës | Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës | Njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës | Kryetari i komunës;<br><br>Ekzekutivi; | Inkorporomi në rend dite;<br><br>Diskutimi në kuvend | Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Dorëzimi i raporteve tremujore financiare në kuvendin e komunës dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare | 2) Raportet e publikuara në ueb-faqe | 1) Tremujori 1 para datës 30 Prill;<br><br>2) Tremujori 2 para datës 31 Korrik;<br><br>3) Tremujori 3 para datës 31 Tetor | Kryetari i komunës;<br><br>Ekzekutivi;<br><br>Zyra e Informimit. | Inkorporomi në rend dite;<br><br>Diskutimi në kuvend;<br><br>Publikimi në ueb-faqe | Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë<br><br>Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna; | |
| | Publikimi i raportit përfundimtar financiar | Raporti i publikuar | Jo më vonë se me 31 mars të çdo viti kalendarik | Kryetari i komunës;<br><br>Ekzekutivi;<br><br>Zyra për Informim. | Ueb-faqja zyrtare e komunës | Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Publikimi i Raportit të zyrës kombëtare të auditimit dhe rekomandimet përcjellëse | 1. Raporti i publikuar;<br>2. Plani i veprimit për përmbushjen e rekomandimeve te auditorit i publikuar. | Pas publikimit nga ZKA | Zyra për informim<br>Zyra e Kryetarit | Ueb-faqja zyrtare e komunës | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Diskutimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kuvendin e Komunës | Raporti i inkorporuar në rend të ditës dhe i diskutuar në KK | Pas publikimit nga ZKA | Kryesuesi i kuvendit<br>Kryetari i komunës<br>Zyra për informim | Inkorporomi në rend dite;<br>Diskutimi në kuvend;<br>Publikimi në ueb-faqe | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Transparenca buxhetore dhe në procedurat e prokurimit publik** | Publikimi i KAB dhe buxhetit vjetor. | KAB dhe Buxheti vjetor të publikuara. | Pas miratimit nga Kuvendin e Komunës. | Zyra për informim;<br><br>Zyra e Kryetarit. | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Promovimi në platforma të tjera. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i listës së projekteve kapitale; | Lista e publikuar | Pas aprovimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës | Zyra për informim;<br><br>Drejtoria përkatëse. | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Promovimi në platforma të tjera | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Publikimi i listës se subjekteve përfituese nga kategoria e subvencioneve | Lista e përfituesve të subvencioneve, e publikuar. | Pas miratimit të listës nga ana komisionit vlerësues | Zyra e informimit;<br><br>Drejtoria përkatëse. | Ueb-faqja zyrtare e komunës; platformat e tjera sociale. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Plani prokurimit për vitin fiskal i aprovuar | Publikimi i Planit të prokurimit i publikuar në ueb-faqe | Pas miratimit dhe shpalljes së ligjit vjetor për ndarjet buxhetore | Zyra e informimit<br><br>Zyra për prokurim | Ueb-faqja e komunës;<br><br>E-prokurimi | Legjislacioni i prokurimit në fuqi<br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të planit për prokurim publik | Raporti i prokurimit i publikuar | Jo me vone se 31 janar, për vitin paraprak | Zyra e prokurimit bashkëpunim me_Zyrën e informimit | Ueb-faqja e komunës | Ligji i Prokurimit Publik;<br><br>Udhëzimit Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike;<br><br>Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i të gjitha aktiviteteve të prokurimit në ueb-faqen e komunës | Numri i aktiviteteve të prokurimit të publikuara në | Në vazhdimësi | Zyra e prokurimit bashkëpunim me_Zyrën e informimit | Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi | Ligji i Prokurimit Publik;<br><br>Udhëzimit Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik;<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i vendimeve dhe të dhënave të tjera të nevojshme të zyrtarëve komunal të autorizuar për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura me operatorët ekonomik të kontraktuar, procesverbalet. Publikimi bëhet në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit per Mbrojtjen e të Dhënave Personale | 1. Numri i zyrtarëve të autorizuar për monitorim sipas vendimeve dhe publikimi i tyre; | Në vazhdimësi. | Zyra e prokurimit bashkëpunim me_Zyrën e informimit | Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi | Ligji i Prokurimit Publik<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Transparenca në menaxhimin e pronës komunale** | Publikimi i listës së pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin fijues | Lista e pronave, e publikuar | Deri me 31 dhjetor. | Zyrën e informimit;<br><br>Sekretaria e kuvendit | Ueb-faqja<br><br>Platforma të tjera | Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i proceseve të ankandit, shprehjes së interesit, negocimit, dhënies në shfrytëzim, këmbimit dhe procedurat tjera të tjetërsimit pronës komunale janë publike. | Proceset e zhvilluara, të publikuara | Në vazhdimësi. | Zyrën e informimit;<br><br>Sekretaria e kuvendit<br><br>Zyra e kryetarit | Ueb-faqja<br><br>Platforma të tjera | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| **Takimet publike dhe konsultimi me qytetarë gjatë procesit të hartimit të politikave** | Mbajtja e se paku dy takimeve publike me qytetare brenda vitit | 2 takime të mbajtura gjatë vitit | Takimi i parë në gjashtëmujorin e parë të vitit;<br><br>Takimi i dytë në gjashtëmujorin e dytë të vitit. | Zyra për informim; | Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës;<br><br>Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit, | Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | mjeteve të informimit;<br><br>Rrjeteve sociale;<br><br>Takime të drejtpërdrejta ; | Administratë të hapur në komuna | |
| | Publikimi i njoftimit për mbajtjen e takimeve me qytetarë për tema specifike | Numri i takimeve të mbajtura | Së paku 8 ditë para takimit. | Zyra për Informim | Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës;<br><br>Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit, mjeteve të informimit;<br><br>Rrjeteve sociale;<br><br>Takime të drejtpërdrejta ; | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| | Konsultimet publike për projektakte dhe dokumente të politikave | 1. Plani i veçantë i konsultimit për projekt propozimet i përfshirë në planin për komunikim me publikun dhe i publikuar. | Deri me 31 janar të vitit. | Kryetari/Drejtoritë/Grupet Punuese për hartimin e projektakteve/projektpropozimeve | Njoftimi bëhet përmes ueb-faqes, platformave te tjera, rrjeteve sociale, | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Publikimi i projekt propozimeve për të cilat kërkohet konsultim publik, të aprovuara;<br><br>3. Publikimi i takimeve/konsultimeve të mbajtura me qytetarë<br><br>4. Publikimi i projekt propozimeve për të cilat është zhvilluar konsultimi me shkrim/formë elektronike në ueb-faqe të komunes/platëformën e konsultimeve publike<br><br>5. Numri i raporteve të konsultimit publik për projektpropozimet e vendosura në konsultim publik | 8 deri në 14 ditë kalendarike para takimit.<br><br>Konsultim zgjatë jo më pak se 15 ditë kalendarike dhe jo më shumë se 30 ditë kalendarike<br><br>Raporti publikohet brenda 5 ditëve kalendarike pas përfundimit të raportit | Zyra për Informim publik | mjeteve te informimit;<br><br>Metodat e zbatimit behet ne pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | | |
| | Mbajtja e dëgjimeve me qytetare për projektbuxhetin e komunës | Dëgjime publike për projektbuxhet, të mbajtura | Së paku 2 (dy) javë para takimit | Kryetari i komunës/Drejtoritë;<br><br>Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore; | Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Zyrtari përgjegjës për konsultime publike;<br><br>Zyra për Informim Publik;<br><br>Zyrtari kryesor i financave. | Takime të drejtpërdrejta ;<br><br>Konsultimet me shkrim;<br><br>Konsultimet elektronike; Publikimi në Platformën qeveritare për konsultime publike; | | |
| | Mbajtja e dëgjimeve me qytetare për Kornizën Afatmesme Buxhetore | Numri i dëgjimeve me qytetarët për KAB | Para datës 30 qershor të atij viti fiskal | Kryetari i komunës;<br><br>Drejtoritë. | Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera;<br><br>Takime të drejtpërdrejta ; Konsultimet me shkrim;<br><br>Konsultimet elektronike; Platforma qeveritare për | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | konsultime publike; | | |
| | Mbledhja/shqyrtimi i komenteve/propozimeve gjatë procesit të konsultimit publik dhe përgatitja raportit për rezultatet e konsultimit publik të KAB dhe projektbuxhetit | 1. Publikimi i konsultimeve publike të mbajtura për KAB-in dhe projektbuxhetin;<br><br>2. Publikimi i raportit të konsultimit për KAB-in dhe projektbuxhetin | Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim. | Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt-propozimit;<br><br>Zyra për Informim Publik. | Publikimi në ueb-faqen e komunës dhe platformën qeveritare të konsultimeve publike. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| **Buxhetimi me pjesëmarrje** | Zbatimi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje | 1. Numri i lokaliteteve të përzgjedhura në buxhetimin me pjesëmarrje<br><br>2. Përqindja e buxhetit të ndarë për projekte të propozuara nga komunitetet lokale në buxhetimin me pjesëmarrje.<br><br>3. Njoftimi për takimet e buxhetimit me pjesëmarrje të publikuara. | <br><br>Së paku 1% e buxhetit të komunës.<br><br>Së paku 7 ditë para takimit. | Kryetari, Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Rrjetet sociale zyrtare dhe kanalet e tjera të informimit. | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kërkesat për informimin, iniciativat qytetare dhe peticionet** | Shqyrtimi i kërkesave/iniciativave dhe peticioneve të qytetarëve | 1) Numri i kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të parashtruara tek Kryetari;<br><br>2) Numri i iniciativave kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të shqyrtuara brenda 60 ditësh;<br><br>3) Numri i njoftimeve të publikut brenda 15 ditësh për kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet e parashtruara | Në vazhdimësi | Kryetari i komunës;<br><br>Kuvendi i komunës.<br><br>Zyra e informimit | | Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |
| **Garantimi i plotë i të drejtave për qasje në dokumentet publike** | Shqyrtimi i rregullt i kërkesave për qasje në dokumente publike | 1) Numri i kërkesave të parashtruara nga palët;<br><br>2) Numri i kërkesave të shqyrtuara për të cilat palët kanë marrë përgjigje | (7) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi, apo (14) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi në rastet e përcaktuara me ligj. | Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare; | Pranimi përmes zyrtarit përgjegjës për konsultime publike.<br><br>Shqyrtimi nga organi kompetent; | Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Hartimi i raportit vjetor për qasje në dokumentet publike | Raporti vjetor i hartuar dhe dorëzuar në Agjencinë për informim dhe privatësi;<br><br>Publikimi raportit vjetor për qasje në dokumentet publike | 31 dhjetor të vitit paraprak, | Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare; | Ueb-faqja e komunës | Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike | |
| | Regjistri me të dhënat zyrtare përgjegjës për qasje në dokumente publike | Publikuar në ueb-faqe | Vazhdimësi | Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare.<br>Zyra për Informim | Ueb-faqja e komunës | Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike | |
| **Përmbushja e kritereve të ueb-faqes zyrtare, lehtësimi i shërbimeve dhe informimi i rregullt për qytetarë lidhur me shërbimet.** | Publikimi i shërbimeve të ofruara | Numri i shërbimeve që ofron institucioni për publikun;<br><br>Numri i procedurave dhe kushteve të përfitimit të tyre dhe afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar të publikuara në gjuhët zyrtare;<br><br>3) Lista e hollësishme e shërbimeve që ofron institucioni për | Në vazhdimësi | Zyra për Informim<br><br>Drejtoria përgjegjëse | Ueb-faqja e komunës;<br><br>Qendra për shërbim të qytetarëve | Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e Institucioneve publike;<br><br>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen, e publikuar në gjuhët zyrtare | | | | | |
